

TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË VLORE 2024

PËRGATITUR NGA:

QENDRA RINORE E VLORËS

RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Vlorë

Përgatiti: Qendra Rinore e Vlorës

Korrik 2024

Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES	3
1. LISTA E SHKURTIMEVE	4
2. HYRJE	5
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT	7
4. METODOLOGJIA E STUDIMIT	8
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR	10
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË VLORË:	11
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË VLORË	13
8. VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK	16
8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË VLORË:	20
8.2 GJETJE NGA INTERVISTAT E ZHVILLUARA ME ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK.	23
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK	26
9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT	26
9.2 PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËRMES VLERËSIMIT ONLINE.	30
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	34
11. REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN)	38
12. ANEKSE	39

1. Lista e Shkurtimeve

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
BP	Buxheti me Pjesëmarrje
KB	Këshilli Bashkiak
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
NED	National Endowment for Democracy
Nj.A	Njësi Administrative
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Center
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Projekt Buxheti Afatëmesëm
POP	Përballja e Ofertave Politike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VYC	Qendra Rinore e Vlorës

2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohej gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën për krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik” zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike”¹ (POP) në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatave anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikën dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën maj – qershor 2024, është realizuar studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik”. Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara² për periudhën shtator 2023 – maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të

¹ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>

² Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç janë Prefekturat, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;• Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;• Qendra Rinore Vlorë,• Epoka e Re, Fier; | <ul style="list-style-type: none">• Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;• Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;• Qendra Rinore për Progres, Kukës,• Gruaja në Zhvillim, Korçë;• Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;• Tjetër Vizion, Elbasan |
|---|--|

3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Në Vlorë, studimi është përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës³, organizatë anëtare e Rrjetit POP, me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi “Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Vlorë” vlerësoi situatën e realizimit të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën shtator 2023 – maj 2024, përmes monitorimit të dëgjësave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik⁴ duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

Gjetjet Kryesore

- Bazuar në gjetjet e këtij studimi, Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Vlorë, duhet të demonstrojnë përgjegjshmëri në kryerjen e detyrave të tyre me efikasitet, efektivitet dhe transparencë, në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Ndërkohë, komuniteti dhe veçanërisht shoqëria civile, nga ana e tyre, duhet të përfitojnë dhe përdorin me mençuri këto mekanizma, duke ushtruar rolin e tyre të domosdoshëm dhe fuqinë që ligji iu jep në sigurimin e një qeverisjeje të drejtë, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit.
- Mobilizimi dhe angazhimi aktiv i qytetarëve në nivel vendor, debati i hapur, ndarja dhe shkëmbimi i përvojave dhe ideve të ndryshme, si dhe shqyrtimi i të gjitha alternativave të mundshme, duhet të jenë reale dhe jo sa për procedurë dhe fasadë, e duhet të realizohet në të gjitha fazat që ligji parashkon, duke mundësuar një vendimmarrje të shëndetshme dhe gjithëpërfshirëse.

³ Faqe zyrtare e VYC: <https://www.facebook.com/VloraYouthCenter>

⁴ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

- Njohja dhe zbatimi efektiv i ligjit, synon të sigurojë transparencën e munguar prej vitesh, ndaj vendimarrjes së KB dhe të bashkisë, të cilët zakonisht i konsiderojnë dëgjuesat publike e konsultimet me publikun, si procese që duhen bërë sa për të qënë në rregull me ligjin, e në më të shumtën e rasteve i anashkalojnë gjithë fazat e dispozitave normative, duke lënë mënjanë dhe duke përjashtuar qytetarët dhe palët të tjera të interesuara (OSHC-të), duke zvogëluar ndjeshëm hapësirat e pjesëmarrjes e për pasojë vendimet që zbatohen bëhen më të vështira për tu pranuar nga të gjithë aktorët e komunitetit.
- Qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese si dhe në ato raste kur raportojnë që kanë qënë pjesë e tyre, ata pohojnë se zëri i tyre nuk dëgjohej, ose mjaft rekomandime nuk gjejnë zbatim.
- Midis krahasimit të kuadrit ligjor, formave të zbatuara dhe vlerësimeve të marra në kuadër të studimit të realizuar, vëmë re se ligji njihet dhe zbatohet në mënyrë modeste nga ana e aparatit ekzekutiv (stafi i bashkisë) ashtu dhe nga legjislativi (anëtarët e KB)
- Transparenca, konsultimi dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen lokale vazhdojnë të jenë sfida për autoritetet vendore, duke shërbyer në të njëjtën kohë dhe si tregues të funksionimit të demokracisë lokale.

Zbatimi i Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik duke përcaktuar qartë se cilat projekt akte i nënshtrohen detyrimisht konsultimit publik në nivel vendor, duhet të qartësojë nevojën për ndryshime ligjore dhe praktika shtrënguese për moszbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Gjithsesi grupet e interesit, OSHC-të lokale dhe qytetarët aktivë në komunitet duhet të rrisin kapacitetet duke njohur të drejtat e tyre, për të ushtruar presion pozitiv dhe për tu ankuar pranë institucioneve përgjegjëse e duke u përballur edhe në gjykatë për çështje me intres të lartë publik.

4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014⁵) në bashkinë Vlorë, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjeteve dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik” realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.⁶
- Rishikimin e dokumenteve strategjike, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të

⁵ Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e>

⁶ Raporti Studimor përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës 2022: <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-vlore/>

Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.

- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë.
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 7 intervista të drejtpërdrejta me stafin e bashkisë si edhe 5 intervista të thëlluara me anëtarë të këshillave bashkiakë. 25 (16F/9M) intervista të thëlluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (10 intervista me OJF, Biznese, aktiviste te shoqerise civile dhe 15 te tjera me qytetare nga grupet e interesit); 110 (64F/46M) pyetësorë online si edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjikë, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkisë e këshillit bashkiak të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme dhe publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtëpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimit Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë e stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thëlluara me koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik, sekretariatit e këshillit bashkiakë dhe aktivistë, qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me proces të pjesëmarrëse.

Pyetësorët e shpërndarë përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në çështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorëve ekspertët e organizatave lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave lokalë, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe u analizuar. Qendra Rinore e Vlorës përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB).

Ky raport studimor është një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen publike, duke synuar një qeverisje më të hapur, transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Vlorë.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau i Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësorë si burime primare⁷ dhe sekondare⁸ për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisin një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisjeje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Vlorë i Ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që

⁷ Si burime primare të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, informacioni në lidhje me procesin e konsultimit publik të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni i përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

⁸ Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.
- Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive⁹ të tyre në procesin e vendimmarrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që l përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Vlorë:

Informacion i përgjithshëm: Bashkia Vlorë përbëhet nga 5 njësi administrative: Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra; në listën e fshatrave përfshihet edhe Sazani. Bashkia e Vlorës ka një popullsi rreth 205,000 banorë dhe një sipërfaqe totale prej 616.85 km². Bashkia e Vlorës shtrihet nga grykëderdhja e lumit Vjosa deri në Llogara, vija bregdetare e bashkisë është më shumë se 90 km¹⁰. Në këtë territor shtrihen qendra të rëndësishme të turizmit detar: Vlora, Narta, Radhima dhe Orikumi. Kjo zonë ka në përbërje dhe parkun detar-bregdetar Sazan-Karaburun, që është i vetmi i këtij lloji në vendin tonë, dhe peisazhin e mbrojtur të sistemit ligatinor Vjosë-Nartë.

Popullsia në vitin 2023¹¹, ishte 200500 banorë, nga të cilët 146500 banorë jetojnë në qytetin e Vlorës dhe 59.000 jetojnë në Nj.A. Numri i bizneseve aktive për vitin 2023 është 5500, ndërsa numri i punonjësve të bashkisë për njëjtin 2024 është 1471 persona nga të cilët 318 janë pjesë e adminsitratës së bashkisë dhe 1153 janë të punësuar në njësitë shpenzuese.

Në bashkinë e Vlorës aktualisht janë duke u zbatuar disa projekte të rëndësishëm në infrastrkturë dhe që janë në studim projekte të tjera zhvillimi në lidhje me zhvillimin e saj të ardhshëm. Pavarësisht se cilësia e rrugëve në vitet e fundit është përmirësuar ndjeshëm vecanërisht përfundimi i Bypass i Vlorës e ka lehtësuar trafikun, mbetet akoma për të bërë për rrugët në fshatra dhe sistemimin e territorit në lagjet e qytetit. Sfidë mbetet gjithashtu menaxhimi i

⁹ Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

¹⁰ [Statistikat Vendore dhe Performanca per Qytetarin - Bashkia Vlorë \(vlora.gov.al\)](https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendimi-Nr.-99.-29.12.2023.pdf)

¹¹ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendimi-Nr.-99.-29.12.2023.pdf> - PBA 2024-2026, fq 10

mbetjeve urbane vecanërisht në periudhën e sezonit turistik ku për shkak të shumfishimit të popullsisë nga ardhja e turistëve rritet intensiteti i mbetjeve në njësinë e kohës.

Këshilli Bashkiak Vlorë, përbëhet nga 51 anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Të ndarë sipas gjinisë janë 27 M/24 F anëtarët e KB kanë ngritur 13 komisione, ndërsa një tjetër komision do ti shtohet së shpejti. Si organ përfaqësues aktualisht rregullon marrëdhëniet dhe ndërveprimin e tij me publikun përmes rregulloreve të brendshme të miratuara si më poshtë:

- *Rregullore për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë.*

E miratuar në mbledhjen e KB Vlorë në maj të 2022¹², me vendim nr.37, janë aprovuar disa shtesa dhe saktësime në “Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë.” Duke shqyrtuar këtë rregullore e cila është e ngarkuar në faqen e internetit¹³ vëmë re se KB ka disa të drejta dhe detyrime për të organizuar njoftimin dhe konsultimin publik (neni 129 – pika 11/c/g, neni 131-132, neni 147, neni 151-152, 154 – pika 3, neni 160 – pika 7,) në marrëdhënie me grupet e interesit dhe qytetarët e NJVQV-së.

- *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat.*

E miratuar me VKB nr 32, në mbledhjen me datë 1 prill 2020, rregullorja përveç ditës simbolike të miratimit të saj, në periudhën e pandemisë, pa konsultim publik, vazhdon të mbetet një dokument në arkivat online që pak njihet dhe realizohet nga vetë anëtarët e KB. Ajo përmban ndër të tjera edhe format e pjesëmarrjes, njoftimit dhe këshillimit të publikut¹⁴, por ende pjesa më e madhe e tyre mbeten të pa realizuara.

Së fundmi me VKB nr.40, në mbledhjen e datës 30 prill 2024, është aprovuar nga KB “*Miratimi i Rishikimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Vlorë*”¹⁵, një dokument i rëndësishëm që pritet të përmirësojë ndërveprimin me qytetarët, më specifiku, bazuar në detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.146/2014. Fusha e gjashtë e tij parashikon informacionin dhe procedurat e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ku përfshihen informacione në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare. Ky program parashikon bashkëpunimin e Këshillit Bashkiak dhe bashkisë Vlorë.

Bashkia Vlorë si organ ekzekutiv përmes kryetarit ka miratuar urdhëra të brendshëm që lidhen me aspektet procedurale dhe zbatimit të Ligji Nr. 146/2014. Në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të administratës¹⁶, miratuar më 2018 nuk ka detyra specifike për koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik dhe drejtori specifike që mbulon këtë pozicion. Gjithësesi në nenin 18 të saj, marrëdhëniet me publikun (qytetarët) të bashkisë Vlorë realizohen nëpërmjet Drejtorisë së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun.

¹² <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2022/05/Vendim-KB-nr.37.pdf>

¹³ <https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Rregullorja-KB-2022-E-MIRATUAR-28-PRILL-2022.pdf>

¹⁴ <https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Rregullorja-e-KB-marrdhenia-me-publikun-dhe-mediat.pdf>

¹⁵ <https://vlora.gov.al/projektvendim-rishikimi-i-programit-te-transparences/>

¹⁶ <https://vlora.gov.al/administrata-e-bashkise/>

Kryetari i bashkisë dhe stafi i bashkisë Vlorë, pas miratimit të “Programit Model të Rishikimit të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore”, përmes një urdhëri të brendshëm, të muajit qershor kanë ngritur grupin e punës dhe caktimin e personave përgjegjës nga stafi i bashkisë me qëllim plotësimin e fushave të përcaktuara në këtë program, duke i dhënë rëndësi të vecantë fushës 6 – atë të pjesëmarrjes qytetare në vendimarrje. Aktualisht programi i rishikuar i transparencës do të koordinohet dhe mbikqyret nga nën/kryetarja e bashkisë Vlorë, duke theksuar rëndësinë e komunikimit me publikun dhe transparencën në vendimarrjen e insitucionit të bashkisë.

Për efekt të studimit më poshtë renditen disa prej proceduarve dhe projektakteve ku bashkia e Vlorës dhe KB janë të detyruar të kryejnë njoftim dhe konsultim publik për qytetarët dhe grupet e interesit:

- Konsultimet me publikun për buxhetin vjetor, sipas ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
- Këshilli bashkiak zhvillon seanca të konsultimeve me publikun për projekt dokumentin e parë të programit buxhetor afatmesëm (brenda muajit maj) dhe të projekt-buxhetit vjetor.
- Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton projektin e parë deri te version final të programit buxhetor afatmesëm, afati nga 30 qershor – 30 shtator. Kryetari i NJQV-së dhe anëtarët e Grupit të Menaxhimit Strategjik realizojnë dëgjesa publike nga 1 shtatori – 30 nëntor, duke ftuar dhe Këshillin Bashkiak për projekt-buxhetin vjetor të vitit pasardhës.
- Plani i përgjithshëm vendor dhe gjithë ndryshimet që lidhen me të, proces që bëhet me konsultim publik.
- Ndryshim destinacioni i pronës publike, që është në inventarin e pronave të bashkisë. Vendimarrja i takon vetëm Këshillit Bashkiak, ndërsa procesi realizohet nga të dyja palët së bashku ose në mënyrë të pavarur.
- Dokumente të brendshme, rregullore, plane veprimi, strategji të prodhuara nga administrata e bashkisë ose nga vetë këshilli bashkiak, para miratimit duhet të nënshtrohen procedurës së konsultimit publik.
- Vendimarrje që ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe kanë efekte financiare, p.sh rrugë publike, parqe eolike, vendepozitime të mbetjeve ku bashkia vendos vetë një pjesë të fondeve.

7. Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në bashkinë Vlorë

Për të mbledhur informacione mbi historikun e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Vlorë, janë monitoruar mbledhje të dëgjësave publike dhe janë konsultuar dokumente të ndryshme të publikuara në faqen e internetit të bashkisë Vlorë, si dhe rregullore e urdhëra të brendshëm, që janë cituar në sesionin e mëparshëm. VYC duke punuar prej vitesh me bashkinë Vlorë, ka prodhuar dhe raporte të mëparshme monitorimi në këtë fushë, si dhe ka nxitur

pjesëmarrjen qytetare në proceset konsultuese sic është buxhetimi me pjesëmarrje apo dhe dëgjesat e realizuara me grupe interesi me të cilat ajo punon prej vitesh.

Bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, ligji nr. 119/20214 “Për të Drejtën e Informimit”, si dhe ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, pjesëmarrja në vendimarrje merr një rol të rëndësishëm, duke mundësuar një lidhje më të ngushtë midis pushtetit dhe qytetarëve duke rritur përgjegjshmërinë për të ofruar shërbime më të mira dhe më efikase. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e qytetarëve në procese të ndryshme vendimmarrëse konsiderohet shumë e rëndësishme.

Në analizën e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, pas daljes së ligjit, në dhjetor të vitit 2015, bashkia Vlorë konsultoi buxhetin vjetor si dhe taksat e tarifave vendore, (process i filluar që në 2011, përmes dëgjesave publike me qytetarët) duke krijuar një model pozitiv që ende dhe sot vazhdon të jetë traditë. Proçesi i konsultimit publik vazhdoi dhe me përgatitjen e Planit të Përgjithshëm Vendor 2017-2030, ku takime me eksperte, grupe interesi dhe organizata u realizuan përgjatë periudhës së përgatitjes së tij. Takime të hapura publike u mbajtën me qytetarë për të shpjeguar ndryshimet që do të preknin bashkinë e re deri në vitin 2030. Gjithashtu dëgjesa publike janë mbajtur edhe për projekte të rëndësishme infrastrukturore për Shëtitoren buzë detit (Lungomare 1-2-3).

Pjesëmarrja në këto dëgjesa ka nxitur reagime qytetare, që në mjaft raste ata ankoheshin për informacion të pamjaftueshëm, mungesë të dokumentacionit mbi projektaktin dhe se rekomandimet e shqetësimet e tyre nuk merreshin parasysh. Edhe pse zhvilloheshin takime me qytetarët, në të kaluarën mungonin procesverbalet për dokumentimin e rekomandimeve/komenteve si dhe pretendimeve të ngritura nga palët, edhe pse ato në pjesën më të madhe të tyre janë transmetuar në mediat lokale të qytetit ose live në rrjetet sociale.

Faqja e internetit të bashkisë Vlorë, që prej 2015 nuk ka një bazë të dhënash për vazhdimësinë e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Faqja e internetit ku bashkia Vlore pasqyron punën e saj, prej vitesh nuk ofron informacione të plota. Ajo ka ndryshuar përmbajtje, tre herë dhe duke lënë mënjanë aksesin në informacion ose pjesëmarrjen online për qytetarët. Dokumente të rëndësishme janë të ngarkuar në faqen e internetit (p.sh Plani i Përgjithshëm Vendor, buxhetet afatmesme, etj) dhe gjenden si ikona, por nëse kërkon të shkarkosh dokumente të caktuara, del njoftimi i zakonshëm “error”. Edhe pas kërkesave të kryera nga OSHC ose individë, që faqja e internetit të jetë miqësore me përdoruesit, ende nuk kemi një ndryshim të situatës.

Për të mos lënë njoftimin dhe konsultimin publik në dorë të ekzekutivit (bashkia) dhe legjislativit (KB) ligji e bën të detyrueshëm garantimin e pjesëmarrjes publike në proceset vendimmarrëse dhe përcaktimin e një **Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**.

Bashkia Vlorë prej 2019 në funksion të procedurave ligjore ka caktuar një person përgjegjës për njoftimin dhe konsultimin publik, ndërsa urdhëri i brendshëm nr. 147 mban datën 8/06/2022, ku përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësisve të koordinatorit janë të parashikuara në Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Detyrave dhe Kompetencave të administratës së bashkisë Vlorë.

Nga një monitorim i thjeshtë i rregullores në internet,¹⁷ koordinatori mban dhe funksione të tjera, kryesisht janë nën varësinë e Drejtorisë së Projekteve të Huaja, Integritet Europian dhe Diasporës, ndërsa nuk gjendet një përshkrim pune me rolin dhe përgjegjësitë specifike të këtij pozicioni në këtë rregullore.

Programi i Transparencës është një tjetër dokument i rëndësishëm, që pas miratimit të tij nga autoritetet publike, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, vihen në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet. Ky program, ka si qëllim plotësimin e detyrimit ligjor për informimin e publikut si edhe transparencën e administratës së bashkisë dhe këshillit bashkiak, për procedurën dhe miratimin e akteve të ndryshme.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka dërguar organeve të QV, një program model rishikimi transparence të miratuar prej tij me urdhërin Nr.211, datë 10.09.2018. Ndërkohë Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) me shkresën Nr. 518 me datë 19.09.2018. ka vënë në dijeni Bashkinë Vlorë se ky projekt është i miratuar dhe se duke filluar nga data 1 Janar 2019 të bëhet i detyrueshëm për tu zbatuar.

Nën asistencën e KDIMDP dhe AMVV-së është miratuar me VKB Nr.129 datë 06.12.2018, Programi i Transparencës, që prej miratimit të tij në dhjetor të 2018 e deri në maj të 2024, programi është zbatuar pjesërisht nga bashkia Vlorë dhe KB.

Në **30 prill 2024**, me VKB nr.40, u miratua **“Programi Model i Rishikimit të Transparencës për Bashkinë Vlorë”**¹⁸. Dokumenti i rishikuar, vjen pas urdhërit të KDIMDP-së për rishikimin e programit model të transparencës. Në takime me staf të bashkisë u vendos që të angazhohej një person përgjegjës në cilësinë e Koordinatorit për Programin e Transparencës. Për këtë qëllim me urdhër të brendshëm nr.197, datë 6 qershor 2024, bashkia Vlorë ka caktuar Nën/Kryetaren e bashkisë, si **Koordinator të Programit të Transparencës** dhe ka ngritur grup pune në funksion të përmbushjes së të gjithë kërkesave që programi kërkon.

Programi i rishikuar, ngarkon stafin e bashkisë dhe KB me detyrime për të publikuar dhe informuar publikun mbi detyrimet që rrjedhin nga ligjet nr. 146/2014, nr. 139/2015, 119/2014. Në mënyrë specifike, programi në **fushën e tij të 6 – Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje**, ngarkon stafin e bashkisë dhe Këshillin Bashkiak të publikojnë: 1. Të dhënat e koordinitorit të njoftimit dhe konsultimit publik; 2. Planin vjetor për procesin e vendimarrjes me pjesëmarrje. 3. Dispozitat e brendshme rregullatore për këshillimin me publikun; 4. Aktivitete për të cilat është e detyrueshme këshillimi me publikun; 5. Njoftimi për nismën vendimarrëse në pjesëmarrje; 6. Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve; 7. Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik; 8. Raport vjetor për procesin e transparencën në vendimarrje; 9. Iniciativa qytetare.

Njëkohësisht edhe **Këshilli Bashkiak**, ka realizuar herë pas here sondazhe online¹⁹ për prioritet e qytetarëve për projekt buxhetin e PBA-së si dhe ka marrë pjesë në dëgjuesat e buxhetimit me

¹⁷<https://vlora.gov.al/administrata-e-bashkise/>

¹⁸<https://vlora.gov.al/transparenca-2/>

¹⁹<https://vlora.gov.al/rezultatet-e-sondazhit-te-prioriteteve-te-komunitetit-se-bashkise-vlore/>

pjesëmarrje²⁰ që organizon së bashku me bashkinë dhe publikun në vitet e kaluara. Edhe pse ka një rregullore të miratuar dhe procedura të qarta vihet re se, iniciativat e ndërmarra nga anëtarët e KB kanë qënë modeste, e në mjaft raste pjesa më e madhe e tyre nuk njohin rolin dhe kompetencat që rrjedhin nga legjislacioni vendor.

Këshilli Bashkiak publikon njoftimet për mbledhjet kryesisht në mediat sociale dhe në disa raste edhe në faqen web të bashkisë. Cdo njoftim përmban të dhëna të mjaftueshme me datën, vendin, orën dhe rendin e ditës, ndërsa aktet e miratuara shpallen në faqen zyrtare të internetit dhe në stendën e njoftimeve publike të Bashkisë Vlorë. Nga monitorimet në faqen web të KB, regjistrat elektronik janë publikuar dhe ndahen në:

- rregjistri për ankesa, kërkesa dhe vërejtje (<https://vlora.gov.al/ankesa/>)
- regjistri i brendshëm i peticioneve dhe iniciativave qytetare (<https://vlora.gov.al/regjistri-i-brendshem-i-peticioneve-dhe-iniciativave-qytetare/>)
- rregjistri i projekt-akteve për konsultim publik të KB (<https://vlora.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/>)
- rregjistri i mbledhjeve të KB dhe takimeve publike në lidhje me mbledhjet e këshillit (<https://vlora.gov.al/takimet-publike-ne-lidhje-me-mbledhjet-e-keshillit/>)

Përsa i përket raportit të transparencës mbi veprimtarinë e KB, në faqen web ndodhet ikona e raporteve, por nuk ka mundësi të shkarkohet asnjë raport. Nevojitet që ky seksion të plotësohet me raportet e transparencës në mënyrë periodike.

Vlerësohet fakti që një pjesë e anëtarëve të Këshillit Bashkiak janë aktivë dhe marrin pjesë në dëgjesat publike që organizohen kryesisht të drejtuara nga bashkia, por kërkohet që bazuar në rregulloret që ata vetë kanë aprovuar, së pari ti njohin ato dhe së dyti ti zbatojnë, përmes marrjes së rolit drejtues në disa prej proceseve që ligji parashkon që duhen konsultuar. Mbeten për tu plotësuar të dhënat e regjistratit të mbledhjeve dhe takimeve publike për KB.

Gjithësesi dhe në lidhje me këtë rekomandim, në mjaft raste anëtarët e KB ankohen se projekt-aktet që duhen konsultuar vijnë në momentet e fundit, pak para se të fillojë mbledhja e radhës, pa dokumentacion të plotë shoqërues, për këtë qëllim ata e kanë të pamundur të organizojnë dëgjesat publike.

8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga

²⁰ <https://bashkiavlore.org/rekrutim/2023/10/06/kalendari-i-konsultimit-publik-bashkia-dhe-keshilli-bashkiak-vlore/>

palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga njoftimi i projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Rrjeti POP dhe VYC përgatitën një kërkesë për informacion²¹, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore me email²² dhe dokumentacion shkresor²³. Në lidhje me informacionin mbi “Zbatimin e proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë, për periudhën shtator 2023-maj 2024” Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Vlorë bazuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vendosi në dispozicion informacionin që është pasqyruar në tabelën më poshtë. Gjithashtu në tabelën përmbledhëse gjeni informacion të thelluar dhe mbi përgjigjet e bashkisë dhe një vlerësim shprehet me i/e realizuar plotësisht, pjesërisht, aspak. Komente rreth gjetjeve nga monitorimi janë në dispozicion të lexuesve të këtij raporti, me qëllim për të vlerësuar efektivitetin e procedurave që zbatohen nga bashkia Vlorë.

TABELË PËRMBLEDHËSE E PËRGJIGJEVE TË BASHKISË DHE KONSTATIMEVE RAPORTIT

Kërkesa për informacion	Përgjigjet e bashkisë Vlorë dhe Këshilli Bashkiak	Komente / Mjetet e verifikimit	Vlerësimi
1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.	Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin publik në Bashkinë Vlorë është znj. Albana Naçi. Email: albana.naci@vlora.gov.al https://vlora.gov.al/te-dhenat-e-koordinatorit-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik/	U.B, Kryetari I Bashkisë nr.147, datë 09.06.2022	I realizuar
2. Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;	Në përgjigjen zyrtare të bashkisë është dërguar linku i vendimeve të KB, që nuk është përgjigja e kësaj kërkesë. https://vlora.gov.al/category/projekt-vendime/ Këshilli bashkiak ka një regjistër elektronik ku janë plotësuar konsultimet që kjo strukturë ka realizuar bashkë me bashkinë ose institucione të varësisë. Më shumë në: https://vlora.gov.al/regjistrimi-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/	Bashkia nuk ka një regjistër elektronik ku janë publikuar projekt-aktet për konsultim publik ka disa forma alternative ku hidhen projekt-aktet, por një regjistër I tillë nuk ekziston. Këshilli Bashkiak disponon një regjistër elektronik ku hidhen projekt aktet që ka konsultuar.	Pjesërisht I realizuar
3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, te publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	Në seksionin e transparencës, bashkia ka publikuar planin vjetor të dëgjësive publike që ka realizuar për vitin 2023-2024. https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/ Edhe Këshilli Bashkiak në sesionin e transparencës në vendimmarrje publikon planë vjetore por faqja nuk ka asnjë informacion. Gjithësesi ky problem	Ka vështirësi në aksesin në faqen e dedikuar të bashkisë dhe duhet të riformatohet në mënyrë që të jetë më e aksesueshme për publikun. Ky plan duhet të realizohet përn gjithë vitin dhe jo për procese të vecanta. Bazuar në programin e transparencës ngarkohet edhe KB që të publikojë këtë plan. Aktualisht janë publikuar vetëm degjesat e realizuara.	Pjesërisht e realizuar

²¹ Kërkesë për Informim - “Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë, për periudhën shtator 2023-maj 2024” protokolluar me nr.7844 në datën 22.05.2024 (ANEKS)

²² Kthimi i përgjigjes nga Koordinatorin për Konsultimit Publik bashkia Vlore, me email më datë 29 maj 2024

²³ Kthim përgjigjeje, nr. Prot 7844/1, më datë 06.06.2024 – dokumentacion shoqëruar shkresor, bashkia Vlorë.

	teknik mund të rregullohet në të ardhmen.		
4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Vlorë •me postë elektronike; •me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues; •me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale; •me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar	Nga përgjigjet zyrtare të bashkisë Vlorë, përdoret zakonisht njoftimi me: - Postë elektronike - Lajmërim në mediat audiovizive rajonale ose lokale.	Nga praktika, është vënë re se njoftimet publikohen në faqen e internetit të bashkisë dhe në mediat sociale të bashkisë dhe KB.	I realizuar plotësisht
5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik •me postë elektronike; •në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. •Tjeter	Sipas bashkisë Vlorë, mënyrat e marrjes së komenteve janë kryesisht: - me postë elektronike; - në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. Edhe KB (sekretariati) konfirmoi të njëjtën mënyrë të marrjes së komenteve.	Nga verifikimi dokumentimi i dëgjësave që ka realizuar bashkia Vlorë në periudhën e monitorimit, komente janë marrë me email, por zakonisht të gjitha janë të shoqëruara me procesverbalet e takimit, ku komentet/rekomandimet janë realizuar në dëgjësë. Të njëjtën procedurë ndjek dhe KB, për dëgjësat që realizon, ndërsa në takimet e monitoruara vihen re që komentet/rekomandimet mbahen edhe nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik dhe nga sekretaria e KB. Theksojme se dëgjësat publike transmetohen live në mediat lokale, kryesisht ato të rrjeteve sociale dhe i bashkëlidhen dokumentacionit shoqëruar të dëgjësave që publikohet dhe në faqen e internetit të KB dhe bashkisë.	I realizuar
6. A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?	Sipas përgjigjes së bashkisë nuk ka patur raste të përsëritjes së fazës së konsultimit publik. Në dokumentacionin e publikuar nga KB, minutat e dëgjësave publike, vetëm në rastin e paktës fiskale 2024-2025, ka të dokumentuara 3 dëgjësas publike. https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Procesverbal-Degjесat-Publike-rreth-Paketes-Fiskale.pdf	Nga monitorimi i dëgjësave publike ka patur raste ku konsultimi është zgjatur për shkak të kontestimit nga ana e qytetarëve ose grupeve të interesit për çështje të vecanta, për këtë qëllim janë realizuar takime të tjera dhe rekomandimet janë marrë parasysh, Rasti i dëgjësës publike për paketën fiskale 2024-2025. Pasi është kërkuar materiali përfundimtar i përgatitur nga bashkia, janë realizuar takime me grupe më të vogla ekspertësh dhe pasi janë dërguar elektronikisht rekomandimet, disa prej tyre janë marrë parasysh. Më shumë në procesverbalin e dëgjësës publike datë 17/11/2023. Minutat në linkun https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/Procesverbal-degjесes-taksat-dhe-tarifат-vendore.pdf	Pjesërisht I realizuar

<p>7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit</p>	<p>Nuk ka përgjigje nga bashkia Vlorë.</p>	<p>Verifikohet se në rastin e dëgjesës për paketën fiskale 2024-2025, janë zhvilluar 3 takime të tjera me grupet e interesit. Dokumentacini mbështetës sigurohet nga procesverbali I mbajtur nga KB, më shumë në https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Procesverbal-Degjesat-Publike-rreth-Paketes-Fiskale.pdf Me kërkesë të grupeve të interesit është zgjatur faza e konsultimit me qëllim marrjen e rekomandimeve dhe rishikimin e paketës fiskale 2024-2025.</p>	<p>Pjesërisht I realizuar</p>
<p>8. Kopje të njoftimit për takime publike</p>	<p>Faqja web e bashkisë Vlore, mediat sociale dhe urdhërat e brendshëm të Kryetarit të bashkisë. Më poshtë janë disa nga modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjesat publike në faqen web të bashkisë Vlorë. https://vlora.gov.al/njoftim-mbi-degjesen-publike-per-projekt-paketen-fiskale-per-taksat-dhe-tarifate-vendore/ https://vlora.gov.al/njoftim-per-degjese-publike-4/ https://vlora.gov.al/degjese-publike-mbi-ndertimin-e-muzeut-hebraik-shqiptar-ne-vlore/</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin vendosur në dispozicion të kërkesës për informim, vihet re se janë përgatitur herë pas here UB të kryetarit të bashkisë, në disa raste njoftime në faqen e internetit dhe mediat sociale. Ndërsa KB zakonisht ndan njoftimet vetëm në mediat sociale dhe faqen e internetit. Mbetet për tu unifikuar forma dhe procedura e njoftimit që publikohet.</p>	<p>Pjesërisht I realizuar</p>
<p>9. Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024</p>	<p>Në linkun e mëposhtëm janë të publikuar procesverbalet e dëgjesave publike të konsultuara në periudhën e kërkuar. https://vlora.gov.al/procedura-e-marejs-dhe-shqyrtimit-te-komenteve-dhe-rekomandimeve/</p>	<p>Në faqen e webit të bashkisë janë publikuar gjithë procesverbalet e dëgjesave publike të realizuara nga bashkia Vlorë. Edhe në seksionin e KB, janë publikuar procesverbalet për disa nga dëgjesat publike të realizuar.</p>	
<p>10. Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”</p>	<p>Për KB janë hedhur projektet-aktet në rregjistrin për konsultim publik të KB. https://vlora.gov.al/regjistri-i-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/ Më poshtë po rendisim disa nga projekt-aktet e miratuara në KB. https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/PROJEKT-VENDIMIN-PERFUNDIMTARE-Per-taksat-dhe-tarifate-vendore-viti-2024.pdf https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2024/01/Vendimi-Nr.-100-29.12.2023-Buxheti-2024.pdf https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2024/06/Vendim-Nr.46-29.05.2024.pdf https://vlora.gov.al/projektvendim-vendqendrimet-dhe-sherbimi-taksi/ https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Projektvendim-Miratimi-i-Planit-per-Reduktimin-dhe-Menaxhimin-e-Zhurmave.pdf https://vlora.gov.al/projektvendim-rregullorja-e-s-p-l-ve/</p>	<p>Nga përgjigjet nuk ka analizë të projektakteve të realizuara me konsultim publik, mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”</p>	<p>Pjesërisht e realizuar</p>

	https://vlora.gov.al/projektvendim-tarifa-per-sherbime-funerales/ https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Projektvendim-Dhenia-e-mendimit-rreth-Shteses-se-Tarifes-Ujesjelles-Kanalizime.pdf		
11. Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023	Bashkëlidhur shkresës, është vënë në dispozicion kopje e raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023. Kopje e raportit të KB për vitin 2023 https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Informacion-Raporti-Statistikor-i-Punes-se-K.B-Vlore.pdf	Raporti vjetor për dëgjesat publike për vitin 2023, është vënë në dispozicion në formatin hard-copy nga koordinatoresha e Njoftimit dhe Konsultimit Publik. KB, e ka miratuar raportin e tij në mbledhjen e muajit janar 2024. Të dyja raportet kanë nevojë të jenë më të thelluara dhe të kenë informacion të plotë, bazuar dhe mbi programin e transparencës, pika 6.	I realizuar
12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.	Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konsultimin publik	Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën shtator 2023– maj 2024.	I realizuar

8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Vlorë

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Vlorë përfshiu 7 zyrtarë, që janë drejtues nga drejtoritë dhe sektorët e ndryshëm të Bashkisë Vlorë, të cilët janë të angazhuar në procese që lidhen drejtëpërdrejtë me njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi ka për qëllim të evidentojë dhe të analizojë format dhe instrumentet që përdor Bashkia për të afruar qytetarët më pranë vendimmarrjes. Intervistat shërbyen dhe për të shkëmbyer ide dhe sygjerime për përmirësimin e punës në lidhje me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, të intervistuarit u pyetën nëse bashkia e tyre ka zhvilluar standardizimin e procedurës administrative për njoftimin dhe konsultimin publik (rregullore të brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarde, verifikim). Të gjithë të intervistuarit konfirmuan egzistencën e procedurave, duke përmendur element të caktuar të saj, sic janë urdhërat e brendshëm të KB për njoftimet e dëgjesave publike, forma standarte të konsultimit dhe dokumentimit por **nuk ka një rregullore ose udhëzim** që rregullon **procesin e njoftimit dhe konsultimit**, bazuar në gjithë nenet që parashkon ligji.

Të intervistuarit renditën disa prej projektakteve që janë realizuar në konsultim me qytetarët për periudhën shtator 2023-maj 2024, duke evidentuar një numër të lartë, **rreth 19 dëgjesa të konsultimit publik**, si p.sh: Dëgjesat e Buxhetimit me Pjesëmarrje në 9 rajone dhe Nj.A për PBA 2024-2026 dhe buxhetin vjetor të 2024; dëgjesat për Takasat dhe Tarifat vendore 2024-2025; për Tarifen e Ujësjellës Kanalizime, dëgjesa për Planin Vendor të Reduktimit të Zhurmave, për

Vendqëndrimin dhe Funkcionimit të Shërbimit Taksi, dëgjesë publike mbi Rregulloren e Shfrytëzimit të Hapësirave Publike (SPL) në territorin e Bashkisë, procedura administrative për përcaktimin e orareve të pastrimit përgjatë sezonit turistik, etj.


Bazuar në eksperincën e krijuar prej vitesh, të intervistuarit nënvizuan se procesi i Buxhetimit me Pjesëmarrje është një prej mekanizmave më efektivë të konsultimit të publikut. Prej vitesh, duke filluar prej 2015, bashkia dhe stafi i saj realizojnë procedurën e njoftimit dhe konsultimit publik, duke konsultuar projek-akte të ndryshme, ndërsa theksojnë se procesi ka ardhur duke u përmirësuar bazuar dhe në eksperincën e fituar ndër vite. Kur u diskutua mbi iniciatorët e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit theksuan se kryesisht ka qënë kryetari i bashkisë, ndërsa në disa raste procese të caktuara kanë qënë kërkesë që vijnë nga organizatat e shoqërisë civile dhe projektet e donatorëve që në bashkëpunim me bashkinë kanë realizuar njoftimin dhe konsultimin publik.

Një rëndësi të vecantë për pjesëmarrjen e publikut në vendimarrje ka dhe programi i transparencës që bashkia, ka për detyrë ta miratojë dhe të vendosë në dispozicion të publikut informacione dhe procedura të prodhuara edhe për pjesëmarrjen e publikut në vendimarrje. Bashkia Vlorë, konfirmon se më datë 30 prill 2024, me VKB nr.40, u miratua “Programi Model i Rishikimit të Transparencës për Bashkinë Vlorë”²⁴ Dokumenti i rishikuar është shoqëruar dhe me ngritjen e një grupi pune dhe caktimin e një personi përgjegjës për plotësimin e të gjitha rubrikave të këtij programi. Pritet që programi i transparencës të bëhet interaktiv dhe i qartë e i kuptueshëm për publikun. Në këtë program të rishikuar gjithë të intervistuarit ishin dakord mbi punën që duhet të bëjnë për publikimin e materialeve që prodhojnë, ndërsa një punë e rëndësishme mbetet për tu bërë edhe nga zhvilluesi i faqes web të bashkisë që materialet të jenë të kuptueshme dhe të plotësohen në mënyrë periodike.

Në bashkinë Vlorë ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, që është emëruar në vitin 2022 dhe është nën varësinë e Drejtorisë së Projekteve të Huaja, Integritit Europian dhe Disasporës. Bazuar në intervistat e realizuara, është e qartë se cdo drejtori pasi vendos të realizojë dëgjesën publike, me miratim dhe nxjerrje të urdhërit nga kryetari i bashkisë, realizon dëgjesën, ku koordinatori mban shënime dhe përgatit raportet e dëgjesave. Rekomandimet/komentet e qytetarëve pasqyrohen në raporte, por vendimarrja për ndryshime i takon drejtorisë/ekipit që është përgjegjës për të aprovuar këtë projekt-akt. Nën këtë këndvështrim, roli i koordinatorit nuk është dinamik dhe në mjaft raste koordinatori nuk ka fuqi të udhëzojë apo të ndërveprojë në mënyrë të pavarur. Roli i tij është gjithmonë mbështetës i sektorit ose drejtorisë që realizon dëgjesën. Zakonisht drejtoritë që përfshihen në procesin e konsultimit publik janë Drejtoria e Menaxhimit Financiar (për procesin e PBA dhe BP); Drejtoria Juridike, Aseteve dhe Pronave; Drejtoria e Informacionit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Kabineti i Kryetarit të Bashkisë (Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët e tij), Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Sektori i Shërbimeve, Urbanistika, Sektori i Zhvillimit të Komuniteteve si dhe cdo drejtori tjetër që ka lidhje me projekt-aktin që konsultohet.

²⁴ <https://vlora.gov.al/projektvendim-rishikimi-i-programit-te-transparences/>

Kur u diskutua për format e njoftimit dhe përfshirjes qytetare, të gjithë të intervistuarit theksuan se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe ato individuale ishin mënyrat më të praktikuara nga bashkia. Ndërkohë bëhen njoftime edhe me email apo gojarisht nga administratorët e rajoneve në qytet dhe administratorët e kryepleqtë në Nj.A. Vërehet që regjistri elektronik, dhe botimet në gazetata lokale thuhet nuk përdoren fare si forma njoftimi për këtë proces. Gjithashtu edhe trasmetimi live i dëgjesave publike ose kronikave përmbledhëse në mediat lokale e sociale, ka rritur nivelin e informimit të qytetarëve për çështje që janë në interes të tyre, por ende pjesëmarrja qytetare mbetet në nivele të ulta. Në grafikun më poshtë janë pasqyruar tre format që përdoren më shumë nga bashkia Vlorë.



Në lidhje me marrjen e komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, të gjithë të intervistuarit u shprehën se ato diskutohen gjatë dëgjesave publike në formë verbale, që më pas rregjistrohen në procesverbal. Edhe pse përfaqësuesit e bashkisë shprehen se jepet një shpjegim rreth arsyeve të organizimit dhe ndikimi që do të ketë dëgjesa publike, gjatë monitorimit është vënë re se shumë pak informacion i detajtuar mbi projekt-aktin ofrohet nga ana e bashkisë.

Është vënë re se mungojnë dokumentet e projekt-aktit dhe diskutohet vetëm në vija të përgjithshme, ndërsa shpjegohet edhe afati e mënyra ku mund të paraqiten rekomandimet dhe komentet, por për shumë qytetarë, ka vështirësi të ndjekin procedurat, përderisa ato janë të paqarta dhe të paunifikuara. Sipas të intervistuarve, qytetarët kanë cdo mundësi që të marrin pjesë dhe të ndryshojnë pjesë të caktuara të projekt-aktit, por zakonisht pas dëgjesës publike, konsiderohet e mbyllur pjesa e marrjes së komenteve. Koordinatori për njoftimin publik, që është përgjegjës dhe për përditësimin e tij, shprehet se ka një rregjistër të dëgjesave publike, por ky rregjistër na u vu në dispozicion vetëm në formatin hard-copy dhe nuk është i ngarkuar në faqen e internetit. Online ngarkohet plani i dëgjesave publike²⁵ dhe raportet e dëgjesave publike (vetëm pjesë të caktuara të këtij regjistri), kryesisht pasi realizohet procesi i konsultimit ose dëgjesës publike. Të gjithë të intervistuarit theksuan se përgjegjësia për mbajtjen dhe përditësimin e këtij informacioni është në dorë të Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

²⁵ <https://vlora.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-me-pjesemarrje/>

Sipas të dhënave nga procesverbalet e dëgjesave për konsultimin publik, rreth 900 (288F/612M) persona kanë marrë pjesë në 19 dëgjesat publike të realizuara në periudhën shtator 2023- maj 2024. Në dëgjesat e realizuara në Nj.A kanë marrë pjesë 350 persona (142F/208M). Listëprezenca e shpërndarë në dëgjesat publike nuk mbledh informacione rreth statusit social apo të punësimit, por gjithësesi nga këqyrja e listës së pjesëmarrësve janë siguruar të dhënat e mësipërme. Në takimet publike kanë marrë pjesë dhe grupe interesi dhe organizata lokale, të cilat kanë njohuri të mira mbi ligjin dhe influencojnë me grupet që përfaqësojnë për çështje të ndryshme të vendimmarjes.

Në bashkinë Vlorë, nuk ka një strukturë që merret me monitorimin dhe vlerësimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Zakonisht zbatimi I ligjit merr vëmendje, kur organet e kontrollit sic janë: Prefektura, KLSH ose KDIMDP kërkojnë informacione shtesë ose vlerësojnë proceset e konsultimit publik.

Procesi i zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, sipas të intervistuarve kalon nëpër shumë vështirësi e sfida që lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës së duhur, e shoqëruar me kapacitete dhe eksperiencë të pamjaftueshme nga ana e stafit të bashkisë. Ata shprehen se ka indiferencë, informacion, ndërgjegjësim dhe pjesëmarrje të ulët qytetare nëpër takime, ndërkohë që bashkia ka vështirësi në përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit. Megjithatë ata mendojnë se kanë ofruar mjete alternative për të rritur aktivizimin qytetar, kjo edhe për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit përmes formave të reja të zbatuara, siç janë publikimi online i dëgjesave publike, shtimi i numrit të dëgjesave që realizohen për projekt-akte të caktuara, etj.

Për të përmirësuar zbatimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Vlorë, nevojat kryesore të evidentuara nga të intervistuarit janë përcaktimi dhe krijimi i procedurave të duhura e të unifikuara, rritja e burimeve materiale , përmirësimi i burimeve njerëzore dhe rritje kapacitetesh përmes trajnimit e asistencës teknike si dhe sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme.

Rekomandimet për të përmirësuar zbatimin e këtij procesi lidhen kryesisht me asistencën teknike, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si edhe informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, për të rritur ndërveprimin dhe bashkëpunimin me stafin e bashkisë.

8.2 Gjetje nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Duke njohur dhe vlerësuar dhe rolin e kontributin e organit legjislativ (KB) në qeverisjen vendore dhe proceset pjesëmarrëse të qytetarëve, një pyetësor u përgatit dhe u shpërnda për 5 përfaqësues të KB²⁶, duke përfshirë sekretarin, kryetaren e KB, përfaqësues nga komisioni juridik, i financave, komisioni i peticioneve.

²⁶ (Aneks – formati i pyetësorit me Këshilltarët Bashkiakë)

Të pyetur mbi opinionin e tyre si këshilltarë vendor mbi perceptimin që ata kanë për rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit, në procesin e hartimit dhe vendimarrjes, të gjithë të intervistuarit shprehën se ata e konsiderojnë shumë të rëndësishëm. Së pari ata vlerësojnë shumë të rëndësishme informimin dhe njoftimin e bashkësisë për projekt-aktet që miratojnë anëtarët e KB. Përveç se është detyrim ligjor, i shprehur dhe në rregulloret e brendshme të KB, të intervistuarit shprehën se ata kanë rritur ndjeshëm informimin ndaj qytetarëve, së pari duke trasmetuar mbledhjet e KB live, por është rritur dhe ndërveprimi me publikun, përmes publikimit e shpërndarjes në mediat sociale dhe në faqen eeb të këshillit të cdo njoftimi për dëgjuesë publike. Gjithashtu edhe këshillimi me bashkësinë në perceptimin e të intervistuarve ka rëndësi shumë të madhe, sepse prej takimeve, këshilltarët marrin informacion të nevojshëm për të ndërvepruar me qytetarët dhe për të marrë rekomandime e komente që janë sa më afër nevojave të komunitetit. Ata tregojnë se kanë qënë prezent në mjaft dëgjesa të organizuara nga bashkia dhe KB.

Përsa i përket përfshirjes së qytetarëve në vendimarrje ata e konsiderojnë të rëndësishme, por jo gjithmonë sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve. Kjo për shkak se ata nuk mund ti detyrojnë qytetarët të jenë prezent në takimet që realizojnë, por theksojnë se ata përpiqen që pas komunikimeve me qytetarët, ti ngrejnë çështjet për diskutim në rendin e ditës së mbledhjes së KB, të pika të ndryshme.

Të anketuarit shprehën se e njohin bazën ligjore, bazuar dhe në rregulloret që janë aprovuar nga KB. Ata mundohen të aplikojnë procedurat që parashikojnë rregulloret, por disa prej procedurave, në mjaft raste nuk përputhen me situatën në realitet. Pengesa të shumta nuk lejojnë që këshilli të marrë rol drejtues, në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, duke i shtuar këtu dhe faktin që shumica e këshilltarëve janë të rinj, e duhet më shumë kohë që nene të caktuara të rregulloreve të aplikohen në marrëdhënie me qytetarët dhe grupet e interesit. Të pyetur mbi vlerësimin që ata kanë për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor të intervistuarit shprehën se rregulloret janë të plota, por realizimi i tyre në praktikë sjell sfida të mëdha. Rregullime të veçanta në nene të caktuar të rregulloreve duhet të të ndodhin sepse aplikimi i tyre në praktikë ka sjellë nevojën për ndryshime. Gjithësesi rregulloret janë të bazuara në ligj dhe ndryshimi i tyre do të ishte në kundërshti me të, por rekomandohet që bashkia mund të përshatsë rregulloren për funksionimin e saj, me qëllim që të parashikojë dhe kohët dhe procedurat për njoftimin e konsultimit publik, që më pas ti kalojë KB, ta zbatojë në kohë dhe jo në situatë emergjence. Bazuar në eksperiencën dhe njohuritë e të intervistuarve dy janë pëgjigjet që janë edhe në kontraditë me njëra-tjetrën. Tre nga pesë të intervistuarit janë shprehur se kuadri ligjor është i qartë por jo i plotë (50%). Ky arsyeim sepse ligji cakton afate fikse që jo në cdo rethanë plotësohen dhe situata kërkon një vendim të përshpejtuar. Do të ishte mirë që adimistrata të sjellë projektakte që kanë nevojë për konsultim, jo në momentet e fundit, por do të ishte mirë që të lihej kohë në dispozicion për dëgjuesat publike. Ndërsa pjesa tjetër (2 në 5) janë shprehur se legjislacioni është i paqartë por i plotë (50%), nisur kjo nga mungesa e praktikave e mundësive se si mund ta realizojnë në territorin e tyre.

Dy janë rregulloret kryesore që rregullojnë veprimtarinë e KB mbi njoftimin dhe konsultimin publik. Ato janë 1). *Rregullorja për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë* dhe

2). *Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat. Gjithashtu dhe Programi i Rishikuar i Transparencës.*

Përsa i përket bashkëpunimit mes këshillit bashkiak dhe bashkisë të gjithë këshilltarët të intervistuar e vlerësojnë atë si të pranishëm. Ata shprehen se ky bashkëpunim intensifikohet në periudhën e fundvitit kur fillon puna për hartimin e buxhetit të vitit pasardhës dhe PBA-së. Për çdo projektvendim që ligji e detyron të bëhet konsultimi publik në faqen e internetit dhe mediat sociale të KB njoftohen qytetarët për të marrë pjesë. Informimi i këshilltarëve për të marrë pjesë në dëgjesat e përbashkëta, bëhet pak ditë para dëgjesës përmes shpërndarjes së kalendarit të dëgjesave publike, në të cilin jepet data dhe vendi ku janë parashikuar të zhvillohen dëgjesat. Këshilltarët përcjellin në takimet e komisioneve ku bëjnë pjesë, prioritetet e qytetarëve që kanë mbledhur nga dëgjesat publike, ku për ato më të rëndësishmet merret një miratim në parim për t'u vendosur në projektakt. Nga eksperiencia, shumë pak nga prioritetet që kanë sjellë këshilltarët janë reflektuar në projektakt dhe për këtë arsye këshilltarët shpesh ndjehen se nuk kanë mundësi të ndryshojnë përmbajtjen e materialit, bazuar në dëgjesat që zakonisht zhvillohen dhe udhëhiqen nga bashkia. Këshilli Bashkiak disponon infrastrukturën e duhur për realizimin dhe ndjekjen e proceduarve të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, por në disa raste kërkohet angazhim më i madh i anëtarëve të KB.

Të pyetur për mjetet që përdor KB për njoftimin dhe konsultimin publik, të intervistuarit zgjedhën si format më të përdorshme mediat lokale (90%) dhe faqen e Facebook-ut (80%). Të tjerat vijnë me lajmërimet publik të afishuar në ambjentet e bashkisë (60%) dhe lajmërimet në grupe whatsapp-i. Nga përgjigjet e të intervistuarve vërehet se lajmërimi përmes regjistrimit elektronik realizohet në faqen e internetit të KB, kryesisht kur procesi realizohet për disa ditë me rradhë.

Këshilltarët referojnë se ligji e parashikon që konsultimi publik realizohet pasi administrata sjell projektaktin, këshilli realizon konsultimin publik. Por kur ka raste emergjente kur dëgjesat publike realizohen së bashku.

Të intervistuarit referojnë se ka një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për dëgjesat publike që ata realizojnë, kjo bazuar në rregulloret e tyre dhe programin e rishikuar të transparencës. Në faqen web të KB janë të publikuara raportet e transparencës, por zakonisht ato nuk janë të aksesueshme nga publiku. Gjithashtu këshilltarët referojnë se bëhen dhe raporte monitorimi nga rekomandimet që dalin nga ligji ku ata përmendin raportin vjetor që përgatitet nga sekretari i KB dhe në të janë të analizuarat të dhënat që dalin nga procesi i dëgjesave publike. Gjithashtu raporte të ngjashme publikohen edhe në programin e transparencës.

Zakonisht rekomandimet dhe komentet që dalin nga dëgjesat publike përfshihen në projektvendimet e buxhetit që propozohet nga bashkia, e në disa raste trajtohen edhe si pikë e veçantë e mbledhjeve të KB (pika të ndryshme).

Të pyetur nëse ka raste të kthimit të projektvendimeve nga KB, nëse nuk është realizuar procedura e njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit u shprehën se nuk ka patur raste të tilla, ata zakonisht gjetjet dhe rekomandimet që dalin nga ky proces, mundohen ti ndjekin deri në zbatimin e tyre përfundimtar.

Në lidhje me mekanizmat e pjesëmarrjes dhe konsultimit që këshilli përdor me qytetarët të intervistuarit theksojnë se **format** që përdorin **gjithmonë** janë: *Buxheti me Pjesëmarrje; faqja e internetit të KB; Mediat sociale, platformat online ose telefonatat; Tjetër – rregjistrat e kërkesave, ankesave si dhe rregjistri i peticioneve.*

Ndër format që përdoren **shpesh** janë: *Seancat dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët; Takimet në lagje, fshatra, njësi administrative.*

Ndër format që KB përdor **ndonjëherë** janë: *Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak; Diskutime në media lokale; Komisionet këshillimore qytetare; Konsultime me ekspertë; Studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve, pyetësorë online.*

Të intervistuarit përmendin disa nga aktet ku KB dhe bashkia kanë kryer konsultime publike për periudhën shtator 2023- maj 2024 që janë të listuar në raportimin e detajuar në sesionet e mëparshme, por mund të përmendim ndryshimet në Planin Vendor; PBA dhe buxheti vjetor; konsultimi i taksave dhe tarifave vendore 2024-2025; Adminisitrimi i aseteve, - Muzeu i Hebrejve në Qendrën Historike; Rregullore për vendqendrimet e taksive; Plani Vendor i Zhurmave, etj. Shpesh KB, shpërndan dhe pyetësorë online për matjen e kënaqësisë së qytetarëve, edhe pse ky proces nuk është realizuar në periudhën e monitorimit që përfshin ky raport.

Në lidhje me sistemin e ankesave, të intervistuarit shprehen se nuk ka ankesa të rregjistruara nga qytetarët, drejtuar KB. Nuk raportohet që KB të ketë sistem të vlerësimit dhe monitorimit të mekanizmave të konsultimit publik, ndërsa cdo vit hartohet raporti i transparencës së procesve vendimarrëse. Kapacitetet e anëtarëve të KB për procedura të njoftimit dhe konsultimit publik, vlerësohen pozitivisht, ata janë të aftë ti ndër marrin dhe ti zhvillojnë procedurat e parashikuara në rregulloret e tyre. Si sfidë ata nënvizojnë faktin se ka mungesa të stafit të trajnuar ose kapacitetet njërëzore në këtë fushë janë të limituara. Ata shprehen se nuk është se mungojnë mekanizmat, por angazhimi qytetar është në nivele të ulta dhe kjo përbën një prej shqetësimeve kryesore në dëgjesat publike që organizohen.

9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi publik

9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Me qëllim matjen e nivelit të njohurive dhe të angazhimit të qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Vlorë, gjatë periudhës maj-qershor ekipi i projektit përgatiti dhe shpërndau 2 formate pyetësorësh.

U përgatit një pyetësor që u shpërnda midis 25 (16F/9M) anëtarëve aktivë në komunitet, përfaqësues të grupeve të interesit, OSHC-ve lokale që kanë informacion rreth procesve të konsultimit dhe/ose kanë marrë pjesë në dëgjesat publike.

Një format i dytë pyetësori, me më pak pyetje u shpërnda online dhe u plotësua nga 110 qytetarë (64F/46M) me qëllim për të matur perceptimin qytetar për konsultimin publik. Në vazhdim do të jepen të dhëna në lidhje me perceptimin qytetar mbi këtë proces të rëndësishëm.

Anketimi u zhvillua me 25 përfaqësues të OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Vlorë, të cilët kishin marrë pjesë në dëgjesat publike. Pyetjet e anketës u përqendruan në të drejtat e pjesëmarrjes, format e njoftimit, pjesëmarrjen në konsultime të ndryshme, dhënien e rekomandimeve, bashkëpunimin me bashkinë, dhe sfidat në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Të pyetur mbi informacionin që kanë mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, të gjithë të intervistuarit janë shprehur se kjo është një e drejtë e tyre dhe e shfrytëzojnë atë për të patur bashkëpunim me administratën e bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Ata janë të ndërgjegjshëm se vendimmarrja e institucioneve vendore, sjell impakt të drejtëpërdrejtë në komunitet dhe grupet e interesit që përfaqësojnë.

Në lidhje me mjetet e përdorura nga institucionet vendore për të njoftuar për të marrë pjesë në dëgjesat publike shumica e të intervistuarve kanë referuar se mjetet kryesore që janë njoftuar kanë qënë: **lajmërimet individuale dhe njoftimet nga mediat sociale të bashkisë/KB**. Të tjerë të intervistuar shprehen se janë njoftuar dhe nga administratori ose kryeplaku, ndërsa disa OSHC lokale raportojnë se janë njoftuar dhe me email, për pjesëmarrje për dëgjesa të ndryshme, kryesisht për plane vendore në fushën sociale të mjedisit, etj. Bazuar nga format e njoftimit dalim në konkluzionin se mjaft herë e vendos vete bashkia ose KB, se kush duhet të marrë pjesë në dëgjesat publike, duke qënë se procesi i njoftimit nuk zbatohet në mënyrë uniforme duke respektuar afatet kohore që ligji pëcakton.

Të pyetur se në cilat nga proceset konsultuese të bashkisë kanë marrë pjesë, të intervistuarit janë shprehur se gjithmonë kanë marrë pjesë në dëgjesat e projekt-buxhetit për vitin 2024 si dhe në konsultimet për taksat dhe tarifat vendore, por dhe në ndryshimet për planin vendor. Përgjigjet janë dhënë kryesisht nga qytetarë aktivë dhe organizatat e biznesit dhe Dhomës së Tregëtisë që prej vitesh ndjekin proceset e mesipërme me qëllim përfaqësimin e grupeve që përfaqësojnë duke ofruar komente dhe rekomandime konkrete. Përsa i përket OSHC-ve ato përgjigjen se ndonjëherë marrin pjesë në konsultime që kanë të bëjnë me miratimin e planeve vendore dhe/ose dëgjesa publike me grupe interesi për buxhetimin me pjesëmarrje.

Të intervistuarit kanë referuar se ndonjëherë kanë dhënë rekomandime me shkrim, por asnjë herë këto komente ata nuk i kanë drejtuar të Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, kryesisht ato i janë dërguar me email dhe në zyrën e protokollit të bashkisë. Pjesa më e madhe e të intervistuarve janë përgjigjur se asnjëherë nuk kanë dërguar komente/rekomandime të Koordinatorit. Ata referojnë se gjatë dëgjesave publike, diskutojnë mbi shqetësimet e tyre dhe komentet që japin kryesisht mbeten aty, e në pak raste këto rekomandime reflektohen në dokumentin final të projektaktit.

Pyetja që synonte të evidentojë bashkëpunimet me bashkinë ose Këshillin Bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar, ose organizuar takime publike në favor të qytetarëve ose grupit të interesit që

përfaqësojnë, u vërejt se të intervistuarit që përfaqësojnë grupimet e biznesit kanë raportuar se kanë pasur bashkëpunime të tilla. Janë organizuar takime shtesë më staf të bashkisë më qëllim ndryshimin e projektakteve. Ndërkohë, pjesa e qytetarëve aktivë dhe OSHC-të, deklaruan se kanë lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në konsultimet publike, duke shpërndarë lajmërimet, por në pjesën më të madhe të rasteve, grupet që ata përfaqësonin kanë marrë pjesë aktivisht në dëgjimet publike.

Vetëm grupet e interesit që përfaqësojnë sektorin e biznesit kanë referuar se rekomandimet e tyre janë marrë parasysh, ndërsa pjesa më e madhe e të intervistuarve referojnë se rekomandimet që kanë bërë nuk janë marrë parasysh. Në disa raste këto rekomandime janë shoqëruar dhe me peticione, kërkesa drejtuar bashkisë ose KB, por nuk ka patur reagim. Të gjithë të intervistuarit tregojnë bashkinë si institucionin kryesor që ka nisur dhe administruar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, ndaj në qasjen e tyre për të ndikuar, ata konsiderojnë bashkinë dhe kryetarin e bashkisë, si institucionin kryesor që udhëheqin procesin e konsultimit.

Qytetarët e grupet e interesit të intervistuar shprehen se mbi eksperiencën e tyre në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik ku kanë marrë pjesë duke dhënë dhënë komentet e tyre në formë verbale dhe/ose me shkrim, të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike

Të gjithë të intervistuarit shprehen se janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka. Por kjo vetem me fjalë, asnjëherë nuk kemi patur në dorë dokumentin ose projektaktin mbi të cilin është duke u organizuar konsultimi. Në disa raste ka vetem disa prezantime në ppt dhe jepet vetëm informacion i përmbledhur. Kjo është një procedurë dhe qasje që duhet të ndryshojë. Qytetarët nuk mund të marrim pjesë në dëgjime publike pa patur në dorë projektaktin që ka nevojë të konsultohet, shprehen pjesa më e madhe e të intervistuarve.

Në formë verbale në takime është shprehur se cdo rekomandim mund ti dërgohet bashkisë pa sqaruar në mënyre konkrete, afatin prej 20 ditësh për marrjen e komenteve/rekomandimeve dhe shumë pak persona e dinë që duhen dërguar te adresa e koordinitorit të njoftimit dhe konsultimit publik në bashkinë Vlorë. Të gjithë të intervistuarit shprehen se ka probleme për afatin, vendin dhe mënyren me të cilën, palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet Gjithashtu nuk tregohet ose publikohet gjatë dëgjësës, adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projekt-aktin.

Koha që grupet e interesit, qytetarët dhe OSHC-të që kanë në dispozicion për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij, është gjithmonë e shkurtër, zakonisht njoftimi merret një ditë para ose ditën kur zhvillohet dëgjesa.

Në vijim, ne lidhje me rekomandimet e qytetarëve nëse janë marrë parasysh, pothuajse të gjithë të intervistuarit shprehen skeptikë. Edhe pse disa prej tyre kanë arritur disa ndryshime konkrete, të gjithë shprehen se konsultimet publike bëhen sa për procedurë. Qytetarëve nuk u krijohet mjedis mundësues nga administrata e bashkisë dhe anëtarët e KB për të arritur ndryshime reale, për tu dëgjuar dhe për të reflektuar komente konkrete në projektakte të caktuara. Të gjithë përmendin faktin se besimi publik e pjesëmarrja është në rënie dhe ka nevojë për ndryshime reale që të fitohet besimi te qytetarët. Fakti që në shumicën e dëgjësive, njerëzit e zakonshëm

nuk marrin pjesë dhe e kanë braktisur këtë të drejtë të tyre, tregon se procedurat bëhen sa për të qënë në rregull me ligjin dhe nuk nxisin një diskutim dhe ndryshim real.

Mungesa e projekt-akteve që konsultohen limiton ndjeshëm aksesin në informacion mos njohja dhe zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik si nga administrata por dhe vetë qytetarët, ka ndikuar drejtëpërdrejtë dhe në braktisjen e qytetarëve të dëgjesave publike, duke hequr dorë nga e drejta e tyre për tu konsultuar për çështje që ndikojnë drejtëpërdrejtë në jetën e tyre. Gjithësesi, ata që njohin ligjin e njoftimit dhe konsultimit publik, e ketu përmendim grupet e organizuara të biznesit, fitojnë epërsi ndaj grupimeve të tjera që kanë informacione të limituara dhe zbatojnë shumë pak etapat e ligjit. Nga monitorimi i dëgjesave publike dhe nga procesverbalet e dëgjesave publike, vihet re që të paktën për dëgjesën e taksave dhe tarifave vendore për 2024-2025, organizatat e biznesit kanë realizuar të gjitha etapat që parashikon ligji, kanë kërkuar marrjen e drafit final gjatë dëgjesave, kanë organizuar takime shtesë dhe kanë dërguar dhe arsyetimin e tyre e rekomandimet me email drejt bashkisë (jo te koordinatori) dhe në fund, rekomandimet e tyre janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në projektaktin përfundimtar që është aprovuar në KB. Përfaqësues të OSHC-ve ose qytetarëve aktivë, në rastet kur nuk kanë qënë dakord me projektaktin, kanë reaguar përmes dërgimit të kërkesë-ankesave dhe rekomandimeve për ndryshim, gjithashtu i kanë ngritur shqetësimet edhe në mediat lokale.


Në lidhje me sfidat për njohjen dhe zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin, pjesa më e madhe e të intervistuarve shprehen se qytetarët kanë pak mundësi të reagojnë, ndërsa bashkia dhe KB, nuk njohin dhe zbatojnë ligjin. Nëse ata nuk futen në ndërveprim me qytetarët ata nuk do të përfshihen dhe nuk do të marrin pjesë në vendimmarrjen lokale. Mbetet një sifidë që duhet kapërcyer edhe njohja e legjislacionit nga ana e qytetarëve, që mund ti shfryëzojnë dëgjesat publike si momente ku mund të sjellin shqetësimet/rekomandimet e tyre më afër vendimmarrjes. Qytetarët nuk mund të çuditen momentet e fundit, kur miratohen projekt-aktet dhe ata nuk janë në djeni për ndikimin negativ në jetën e tyre, por duhet të ndërgjegjësohen mbi të drejtat e tyre, të krijojnë grupe interesi, që i mbështesin dhe advokojnë, në funksion të përmbushjes së qëllimit final.

Edhe OSHC-të lokale, nuk mund të presin të reagojnë pasi vendimet merren, por duhet të risin aftësitë e njohuritë e tyre si të ndikojnë hershëm për interesat dhe grupet që përfaqësojnë. Ndaj këshillohet që ligji të njihet në të gjitha fazat e tij dhe OSHC që punojnë në territor duhet të rrisin kapacitetet e tyre dhe të ndajnë informacion e të ngrenë kapacitetet e qytetarëve dhe grupeve që përfaqësojnë. Edhe procesi i monitorimit e ankimimit është i rëndësishëm, që të kuptohet dhe të realizohet për vendimmarje që bien ndesh me interesin publik, e mekanizmat e kontrollit të funksionojnë, e autoritetet që kanë për detyrë mbikqyrjen e procesit të reagojnë së bashku me qytetarët që preken nga moszbatimi i ligjit të konsultimit publik.


Gjetjet e studimit tregojnë se qytetarët nuk kanë besim të bëhen pjesë e proceseve konsultuese si dhe në ato raste kur raportojnë që kanë qënë pjesë e tyre, ata pohojnë se zëri i tyre nuk dëgjohet, ose mjaft rekomandime nuk gjejnë zbatim.

9.2 Perceptimet e qytetarëve përmes vlerësimit online.

Për të mbledhur perceptimin e qytetarëve të ndryshëm në lidhje me njohuritë ose praktikat që kanë mbi njoftimin dhe konsultimin publik një pyetësor online u përgatit dhe shpërnda në 10 bashkitë ku Rrjeti POP punon. Në mediat sociale të Rrjetit dhe të organizatave lokale pyetësorët u shpërndanë me qëllimin për të matur impaktin që kanë qytetarët kanë mbi procesin. Në lidhje me pyetësorët e shpërndarë online në Vlorë janë plotësuar 110 pyetësorë (64F/46M), nga të cilët 84% janë banorë të zonës urbane dhe 16% janë banorë të zonave rurale të bashkisë.




Në lidhje me moshën e pjesëmarrësve që kanë plotësuar pyetësorin online, kryesisht ai është plotësuar më së shumti nga gruposhat 15-29 vjeç dhe 30-45 vjeç, që përbëjnë dhe gruposhat më aktive në përdorimin e rrjeteve sociale. Më poshtë është pasqyruar grafikisht pjesëmarrja sipas gjinisë dhe grupmoshave që janë përfshirë në vlerësimin online.



Të pyetur mbi njohuritë që qytetarët kanë mbi ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, 49% e të intervistuarve shprehen se kanë njohuri mbi këtë ligj, ndërsa 51% e të anketuarve shprehen se nuk kanë njohur mbi këtë ligj. Duke vlerësuar nga grafiku më poshtë, vëmë re se vajzat e grupmoshës 15-29 vjeç nuk kanë njohuri mbi këtë ligj duke konfirmuar dhe apatinë kryesisht të vajzave të kësaj grupmoshe që nuk marrin pjesë në dëgjesa publike, ndërsa krejt e kundërta është me vajzat e gratë e grupmoshës 30-45 vjeç, që shprehen se kanë njohuri mbi këtë proces e ligj të rëndësishëm,

Nga të dhënat del në pah se në përgjithësi, njohuria për ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik varion shumë midis grupeve të ndryshme moshe dhe gjinie. Femrat në grupin moshor 15-29 vjeç


dhe meshkujt në grupin moshor mbi 65 vjeç duket të kenë më pak njohuri për ligjin në krahasim me grupet e tjera. Ndërsa meshkujt dhe femrat në grupin moshor 30-45 vjeç kanë nivelin më të lartë të njohurisë për këtë ligj. (grafiku 4)




Në lidhje me pyetjen e drejtuar në pyetësorin online **nëse qytetarët kanë marrë pjesë në dëgjesat publike të organizuara nga bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak** vihet re se **67%** e të pyeturve **nuk kanë marrë pjesë**, ndërsa **29% kanë marrë pjesë** në këto dëgjesa dhe **4%** nuk kanë dhënë një përgjigje për këtë pyetje.

Për grupmoshën, 15-29 vjeç, një numër i konsiderueshëm konfirmojnë se nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike, pjesëmarrja është relativisht e ulët për të dy gjinitë, por veçanërisht për femrat janë ato që nuk janë pjesë e këtyre proceseve.


Nga të dhënat del në pah se pjesëmarrja në dëgjesat publike është e ulët, veçanërisht tek grupmoshat më të reja dhe kryesisht femrat janë ato që nuk marrin pjesë. Ky trend tregon nevojën për nisma më të mira informuese dhe përfshirëse për të rritur pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse lokale. Përmirësimi i qasjes dhe angazhimit në dëgjesat publike është thelbësore për të siguruar që vendimet merren së bashku me qytetarët. (Grafiku 5)




Duke qënë se një pjesë e madhe e të intervistuarve kanë pohuar se nuk kanë qënë pjesë e dëgjesave publike në dy vitet e fundit, rreth 67% ata janë pyetur mbi arsyet pse nuk kanë qënë pjesë e konsultimeve. Në grafikun 6/1, pjesa më e madhe e tyre konfirmojnë se nuk kanë qënë të informuar se kur mbahen konsultimet publike, e ndjekur me shprehjen nuk më intereson, që tregon besim të ulët të vendimet që merr bashkia dhe KB, e ndjekur nga konfirmimi tjetër që qytetarët nuk marrin pjesë se mendimet e tyre nuk merren parasysh.




Për qytetarët që janë përgjigjur pozitivisht pyetjes që kanë marrë pjesë në dëgjesat publike që përbëjnë rreth 29% të të gjithë të intervistuarve, ata janë pyetur mbi mënyrat si janë vënë në djeni të procesit. Përgjigjet mbi njoftimin e procesit janë nga njoftimet në faqen web të bashkisë, lajmërimet individuale dhe njoftimet nga administrator/kryeplaku. (Grafiku 6)




Të pyetur nëse janë marrë në konsideratë vërejtjet/sugjerimet/komentet e pjesëmarrësve në dëgjesat publike, ata shprehen në pjesën më të madhe se nuk e dinë ose nuk merren parasysh.



Të gjithë pjesëmarrësit në vlerësim i janë përgjigjur pyetjes nëse janë ankuar në lidhje me ndonjë aspekt të konsultimit publik, përgjigjet janë pasqyruar në grafikun 8 si më poshtë:



Në sesionin e fundit qytetarët pyeten mbi besimin nëse përmirësohet vendimmarrja, po të zbatohen me përpikmëri procedurat e konsultimit publik. Të dhënat tregojnë një besim të konsiderueshëm nga ana e qytetarëve në përmirësimin e vendimmarrjes përmes zbatimit të



procedurave të konsultimit publik. Ky besim është një burim i rëndësishëm për rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e qeverisjes vendore. Për të përfituar nga ky potencial, është e nevojshme që institucionet vendore të përmirësojnë transparencën, të rrisin ndërgjegjësimin dhe të angazhojnë aktivisht qytetarët në këto procese.

10. Konkluzione dhe Rekomandime

Bazuar në analizën e situatës konkluzionet janë të grupuara për gjithë aktorët insitucionalë dhe qytetarë që janë përfshirë në këtë studim:

Konkluzionet për Bashkinë Vlorë:

- Edhe pse bashkisë Vlorë i kërkohet të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes, përmes instrumentit të konsultimit, **ende nuk ka proceduara të unifikuara** ku pjesëmarrja qytetare të jetë një **proces transparent dhe i drejtpërdrejtë** mes administratës së bashkisë, anëtarëve të KB dhe qytetarëve.
- Ky proces **duhet të zhvillohet në mënyrë të unifikuar dhe në mënyrë të vazhdueshme** sipas procedurave të përcaktuara në ligj.
- Bashkia Vlorë prej vitesh realizon proceset e njoftimit dhe konsultimit publik, por në **faqen e internetit** ende nuk vendoset **informacion i qartë dhe i detajuar** mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimin e debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.
- Programi I rishikuar I transparencës në bashkinë Vlorë, përveç vendosjes së një personi përgjegjës në rolin e **Koordinatorit të Programit të Transparencës**, pritet të sjellë dhe ndryshime konkrete në administrimin dhe publikimin e të dhënave e dokumenteve që bashkia dhe KB, prodhojnë në funksion të rritjes së transparencës dhe vendimmarrjes.
- Përsa I përket **raportit të transparencës** mbi veprimtarinë e **KB**, në faqen web ndodhet ikona e raporteve, por nuk ka mundësi të shkarkohet asnjë raport. Nevojitet që ky seksion të plotësohet dhe raportet e transparencës të prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.
- Në lidhje me analizën e projektakteve të realizuara me konsultim publik, mungon informacioni që shoqërohet me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
- Pas kërkesës për informacion u vendos në dispocionin një **numër i lartë** konsultimesh të kryera midis periudhës shtator 2023 – maj 2024 në total **19 dëgjesa**, ku në pjesën më të madhe të tyre kishte informacion të qartë dhe të detajuar mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, por jo gjithmonë janë respektuar të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projekt-aktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, respektimi i afatit 20 ditor, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

Konkluzionet për Këshillin Bashkiak Vlorë:

- Të gjithë të intervistuarit vlerësojnë shumë të rëndësishëm informimin dhe njoftimin e qytetarëve për projekt-aktet që miratojnë anëtarët e Këshillit Bashkiak (KB). Informimi

është përmirësuar përmes transmetimeve live të mbledhjeve të KB dhe rritjes së ndërveprimit me publikun përmes mediave sociale dhe faqes së internetit të këshillit.

- Këshillimi me bashkësinë, konsiderohet shumë i rëndësishëm për mbledhjen e informacionit dhe rekomandimeve që janë afër nevojave të komunitetit. Anëtarët e KB kanë qenë prezentë në shumë dëgjesa publike por bazuar në rregulloret e tyre ata duhet të marrin rol drejtues dhe ti realizojnë proceset edhe në mënyrë të pavarur nga bashkia.
- Anëtarët e KB njohin mirë bazën ligjore dhe përpiqen të zbatojnë procedurat e parashikuara në rregulloret, megjithatë ka pengesa që pengojnë zbatimin e plotë të këtyre procedurave në praktikë. Njohja e bazës ligjore përbën sfidë dhe kërkon kohë për t'u përshtatur me situatën reale.

Konkuzione për qytetarët, grupet e interesit dhe OSHC-të:

- Nevojiten që qytetarët të ndërgjegjësohen për të drejtat e tyre në lidhje me konsultimin publik, Ata duhet ta shfrytëzojnë këtë të drejtë për të bashkëpunuar me administratën e bashkisë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak, për të marrë vendime të konsultuara së bashku.
- Mjetet kryesore të njoftimit konsultimit publik, janë njoftimet individuale dhe mediat sociale të bashkisë/Këshillit Bashkiak. Megjithatë, procesi i njoftimit e konsultimit publik, nuk zbatohet në mënyrë uniforme dhe shpeshherë bashkia ose Këshilli Bashkiak limitojnë pjesëmarrjen qytetare duke mos zbatuar detyrimet dhe afatet kohore që ligji përcakton.
- Pjesëmarrja qytetare ka qënë më e madhe në konsultimet publike për dëgjesat e projekt-buxhetit, taksat dhe tarifat vendore, dhe ndryshimet për planin vendor. Qytetarët aktivë dhe organizatat e biznesit kanë qënë më të angazhuar në këto procese.
- Roli i shoqërisë civile dhe qytetarëve, duhet të forcohet për të siguruar pjesëmarrjen dhe konsultimin kuptimplotë në proceset e politikëbërjes në Bashkinë Vlorë.
- Gjithashtu nevojitet që të informohen komunitetet përkatëse mbi këto të drejta dhe mënyrën e ushtrimit të tyre duke i dhënë zë parashikimeve në rregullore.
- Grupet e interesit që përfaqësojnë sektorin e biznesit ka pasur bashkëpunime më të afërta me bashkinë. Ndërsa OSHC-të dhe qytetarët aktivë kanë lehtësuar pjesëmarrjen e publikut, por rekomandimet e tyre shpesh nuk merren parasysh.
- Në dëgjesat publike, qytetarët dhe grupet e interesit shpesh nuk kanë në dorë dokumentet ose projektaktet që konsultohen. Kjo mungesë transparence ndikon negativisht në pjesëmarrjen dhe efektivitetin e konsultimeve.
- Shumica e të intervistuarve janë skeptikë për efektivitetin e konsultimeve publike, duke menduar se këto bëhen vetëm për të përmbushur procedurat ligjore pa një ndikim real në vendimmarrje.
- Mungesa e projekt-akteve dhe njohuria e kufizuar e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik kanë ndikuar në braktisjen e qytetarëve të dëgjesave publike. Grupet e interesit lryesisht të sektorit të biznesit kanë epërsi për shkak të njohurisë dhe përdorimit të ligjit.
- Qytetarët kanë pak mundësi të reagojnë, ndërsa bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk njohin dhe zbatojnë ligjin në mënyrë të plotë. Njohja e ligjit nga qytetarët dhe OSHC-të mbetet një sfidë e rëndësishme që duhet kapërcyer.

Rekomandime

Rekomandimet që po paraqesim përveçse kontribuojnë në zbatimin efektiv dhe cilësor të ligjit, ndihmojnë që procesi i konsultimit të mos mbetet formal, por t'i shërbejë qëllimit që ai ka në funksion të: (i) një qeverisjeje më të hapur, transparente e për pasojë, më demokratike; (ii) rritjes së shkallës së zbatimit të legjislacionit, në kuadër të pranimit më të gjerë të tij nga publiku.

- Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkia duhet të vijoj të kërkojë, adaptojë e praktikojë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interesit dhe shoqëria civile të marrin pjesë në vendimmarrje dhe të shihen si partnerë të domosdoshëm të procesit të konsultimit publik.
- Mungesa e njohurive dhe e vullnetit për zbatimin e ligjit të konsultimit publik, nuk mund të lihet në diskrecion të autoriteteve të qeverisjes vendore, në këtë rast bashkia dhe KB, por duhet të forcohen dhe njohuritë e qytetarëve që të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të atakojnë akte dhe vendime të veçanta në kundërshtim me interesin publik, përmes ushtrimit të të drejtave të tyre dhe në institucione të kontrollit ku përmendim institucionin e Prefektit, KLSH-në apo KDIMDP, e në rastë të veçanta edhe gjykatën.
- Nuk ka një bazë të dhënash të plota mbi procesin e konsultimit publik. Përveç dokumentimit të dëgjësave, nuk ka mënyra për të identifikuar sa nga komentet dhe rekomandimet janë marrë parasysh, duke u reflektuar në dokumentet përfundimtare të aprovuara.
- Zbatimi i ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik duhet të realizohet përmes edukimit të NjVQV dhe qytetarëve që të sigurojë gjithëpërfshirje në vendimmarrje.
- Programi i rishikuar i transparencës në bashkinë Vlorë, përveç vendosjes së një personi përgjegjës në rolin e Koordinatorit të Programit të Transparencës, pritet të sjellë dhe ndryshime konkrete në administrimin dhe publikimin e të dhënave e dokumenteve që bashkia dhe KB, prodhojnë në funksion të rritjes së transparencës dhe vendimmarrjes.
- Rregulloret e aprovuara nga Këshilli bashkiak, duhet të jenë të njohura nga vetë anëtarët dhe të jenë udhëzues në punën e tyre për ti zbatuar në vendimet që ata marrin, ndërsa kërkohet që për disa procese të veçanta të konsultimit publik, vetë Këshilli duhet të marrë rol drejtues në fillimin dhe realizimin e tyre.
- Rekomandohet që informacioni i publikuar në faqen e internetit të jetë miqësor për përdoruesit, duke u dhënë me tepër akses në të drejtat e tyre.
- Është e nevojshme të përmirësohet kontrolli i cilësisë së konsultimeve publike dhe të sigurohet ndjekja e tyre e duhur. Gjithashtu, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të inkurajuar pjesëmarrjen e palëve të interesuara, veçanërisht të shoqërisë civile.
- Këshilli Bashkiak duhet të intesifikojë fushatat e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në dëgjesat publike.
- Zbatimi i metodave të reja për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, si p.sh., platforma interaktive online dhe aktivitete në komunitet do të risin besimin e publikut.

- Rekomandohet që disa nene të vecanta të rregulloreve të KB që trajtojnë në mënyrë të veçantë ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, të përshtaten për të reflektuar më mirë situatat reale dhe për të lehtësuar zbatimin e tyre në praktikë.
- Shmangia e sjelljes së projekt-akteve për konsultim në momentet e fundit nga administrata e bashkisë, për të siguruar kohë të mjaftueshme për konsultim publik nga ana e Këshillit Bashkiak.
- Rekomandohet zhvillimi i mekanizmave të rinj për matjen e kënaqësisë së qytetarëve dhe për përmirësimin e ndërveprimit me ta.
- Përdorimi më i gjerë i seancave dëgjimore dhe takimeve në komunitet për të siguruar një përfshirje më të gjerë dhe efektive të qytetarëve.
- Ngritja e kapaciteteve të stafëve të bashkisë dhe anëtarët e KB për njoftimin dhe konsultimin publik.

Për qytetarët, grupet e interesit dhe OSHC-të

- Duhet të krijohen mekanizma që të nxisin pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe OSHC-ve në konsultimet publike. Kjo mund të përfshijë organizimin e takimeve informative dhe trajnimeve mbi ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.
- OSHC-të duhet të rrisin kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje. Trajnime dhe burime shtesë mund të ndihmojnë në përgatitjen e tyre për të përfaqësuar interesat e komunitetit në mënyrë efektive.
- Promovimi i bashkëpunimit të vazhdueshëm midis bashkisë, Këshillit Bashkiak, qytetarëve dhe OSHC-ve për të siguruar që të gjithë palët të jenë të përfshira dhe të dëgjura në procesin e konsultimit publik.
- Krijimi i mekanizmave efektivë për monitorimin dhe ankimimin e vendimeve që bien ndesh me interesin publik. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit mbi këto mekanizma dhe sigurimin që ata të funksionojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente.
- Fushata edukuese dhe ndërgjegjësimi publik mbi të drejtat e qytetarëve për pjesëmarrje në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik do të ndihmojnë në rritjen e angazhimit të qytetarëve dhe në ndërtimin e një kulture të pjesëmarrjes aktive.
- Kontrolli i cilësisë së konsultimeve duhet të forcohet dhe të sigurohet ndjekja e duhur, dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të inkurajuar palët e interesuara, veçanërisht shoqërinë civile dhe qytetarët të marrin pjesë.

11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)

Faqja e internetit të Bashkisë Vlorë

<https://vlora.gov.al/>

<https://vlora.gov.al/transparenca-2/>

<https://vlora.gov.al/administrata-e-bashkise/>

[Regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve-Janar-Maj-2024-1.docx \(live.com\)](#)

Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë.

<https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Rregullorja-KB-2022-E-MIRATUAR-28-PRILL-2022.pdf>

Rregullore për Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Mediat.

<https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2020/03/Rregullorja-e-KB-marrdhenia-me-publikun-dhe-mediat.pdf>

Lista e procesverbaleve të Këshillit Bashkiak Vlorë

<https://vlora.gov.al/category/proces-verbale-per-kb/>

Miratimi I Rishikimit të Programit të Transparencës të Bashkisë Vlorë

<https://vlora.gov.al/projektvendim-rishikimi-i-programit-te-transparences/>

<https://vlora.gov.al/kordinatori/regjistri-kerkesave-informacion/>

12. Anekse

Aneks 1: Kërkesa për Informacion për bashkinë Vlorë



Adresa: Pallati i Kulturës “Labëria” Kati I, Vlorë, AL
Tel/fax: +355 33 203064
E-mail: vlorayouthcenter@gmail.com
Facebook: Qendra Rinore e Vlores/Vlora Youth Center
Instagram: vlorayouthcenter

Nr. 1 prot.

Vlorë, më 21 Maj 2024

KËRKESË PËR INFORMIM

Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”

Drejtuar: Z. Ermal Dredha, Kryetar i Bashkisë Vlorë
Për djeni: Znj. Desilda Çaçi, Koorditore për të Drejtën e Informimit, Bashkia Vlorë

Lënda: Zbatimi i procesve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë, për periudhën shtator 2023 – maj 2024.

I nderuar z. Kryetar,

Shoqata Qendra Rinore e Vlorës si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) <https://popnetwork.al/> po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë për periudhën shtator 2023 – maj 2024.

Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, dhe nenit 6, nenit 9, nenit 10, neni 11, neni 16, neni 17, neni 18, neni 19, neni 20 dhe neni 21, të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kërkojmë të na informoni:

- 1) Emrin, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.
- 2) Linkun e regjistrimit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- 3) Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, të publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
- 4) Mënyrat e njoftimit gjate procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Vlorë
 - *me postë elektronike;*
 - *me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;*
 - *me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;*
 - *me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar.*

- 5) Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik
- *me postë elektronike;*
 - *në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.*
 - *Tjeter*
- 6) A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?
- 7) Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit
- 8) Kopje të njoftimit për takime publike
- 9) Kopje te Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024
- 10) Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
- 11) Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023
- 12) Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike të poshtëshënuar:

Email: vlorayouthcenter@gmail.com



DB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PROJEKTEVE TË HUAJA INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

Nr. 7844/1 prot.Vlorë, më 0606 2024

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

ZNJ. ALKETA LAMANI ✓

QENDRA RINORE, PALLATI I KULTURËS "LABËRIA" KATI I 1, VLORË

Në përgjigje të kërkesës tuaj me lëndë "Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë, për periudhën shtator 2023-maj 2024" protokolluar me nr. 7844 në datën 22.05.2024, në cilësinë e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Vlorë, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ju vendos në dispozicion informacionin që unë disponoj:

1) Emrin, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.

Koordinatori për njoftimi dhe konsultimin publik në Bashkinë Vlorë është znj. Albana Naçi.
Email: albana.naci@vlora.gov.al
<https://vlora.gov.al/te-dhenat-e-koordinatorit-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik/>

(Bashkangjitur Urdhëri i emërimit.)

2) Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik";
<https://vlora.gov.al/category/projekt-vendime/>

4) Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Vlorë

me postë elektronike;

me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

5) Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik
 me postë elektronike;

x në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

6) A ka patur raste kur është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit?

Jo, nuk ka patur raste të zgjatjes ose përsëritjes së fazës së konsultimit publik

7) Nëse Po, ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit

8) Kopje të njoftimit për takime publike.

Njoftimet janë kryer nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë Vlorë. Konsultoni linkun më poshtë. Bashkëlidhur shkresës, kopje e njoftimit për takim publik.

<https://vlora.gov.al/>

9) Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024

Bashkëlidhur shkresës, kopje të procesverbaleve të takimeve publike.

Në linkun e mëposhtëm janë të publikuar procesverbalet e dëgjësave publike të konsultuar në periudhën e kërkuar nga ana juaj.

<https://vlora.gov.al/procedura-e-marejs-dhe-shqyrtimit-te-komenteve-dhe-rekomandimeve/>

10) Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Në faqen zyrtare të internetit të bashkisë gjeni projektaktet e miratuara për periudhën e kërkuar.

<https://www.vendime.al/category/vore/2023-vendime-te-keshillit-bashkiak-vlore/>

<https://www.vendime.al/category/vlore/2024-vlore/>

11) Kopje të Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023

Bashkëlidhur shkresës, kopje të raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023.

12) Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.

Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konsultimin publik.

KRYETAR

Ermal Dredha



Aneks 3: Kthim përgjigje me email – Koordinatorit I Njoftimit dhe Konsultimit Publik



Qendra Rinore e Vlores / Vlora Youth Center <vlora.youthcenter@gmail.com>

Kthim përgjigje per kerkesen

1 message

Alba Naci <albana.naci@gmail.com>

Wed, May 29, 2024 at 9:51 AM

To: Qendra Rinore e Vlores / Vlora Youth Center <vlora.youthcenter@gmail.com>, desilda.caci@vlora.gov.al

Pershendetje znj.Lamani,
Uroj te jeni mire!

Në përgjigje të kërkesës tuaj me lëndë "Zbatimi i proceseve të ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në Bashkinë Vlorë, për periudhën shtator 2023-maj 2024" protokolluar me nr.7844 në datën 22.05.2024, në cilësinë e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik për Bashkinë Vlorë bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ju vendos në dispozicion informacionin që unë disponoj:

1)Emrin, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij.

Koordinatori për njoftimi dhe konsultimin publik në Bashkinë Vlorë është znj.Albana Naçi. Email: albana.naci@vlora.gov.al
<https://vlora.gov.al/te-dhenat-e-koordinatorit-per-njoftimin-dhe-konsultimin-publik/>

2) Linkun e regjistrat elektronik ku jane publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënavet të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) e ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik";
<https://vlora.gov.al/category/projekt-vendime/>

4) Mënyrat e njoftimit gjate procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Vlorë jane:

me postë elektronike;

me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

5) Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik me postë elektronike; në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

6) A ka patur raste kur është zgjidhur ose përsëritur faza e konsultimit?
Jo, nuk ka patur raste të zgjatjes ose përsëritjes së fazës së konsultimit publik.

7) Nese Po, ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjidhur ose përsëritur faza e konsultimit

8) Kopje të njoftimit për takime publike.
Njoftimet janë kryer nëpërmjet faqes së websitet të Bashkisë Vlorë. Konsultoni linkun më poshtë.
<https://vlora.gov.al/>

9) Kopje te Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024.
Bashkëlidhur shkresës, kopje të procesverbaleve të takimeve publike.
Në linkun e mëposhtëm janë të publikuar procesverbalet e dëgjesave publike të konsultuara në periudhën e kërkuar nga ana juaj.
<https://vlora.gov.al/procedura-e-marejs-dhe-shqyrtimit-te-komenteve-dhe-rekomandimeve/>

10) Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"
Në faqen zyrtare të websitet të bashkisë gjeni projektaktet e miratuara për periudhën e kërkuar.
<https://www.vendime.al/category/vlore/2023-vendime-te-keshillit-bashkiak-vlore/> <https://www.vendime.al/category/vlore/2024-vlore/>

11) Kopje te Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023
Bashkëlidhur shkresës, kopje të raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes per vitin 2023.

12) Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave.
Në institucion nuk ka të depozituar ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konsultimin publik.

Aneks 4: Pyetësi me staf të Bashkisë Vlorë

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike" financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara²⁷, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për bashkinë:

Bashkia _____

Nr. i njësive administrative _____

Nr. i banorëve _____

Mbulimi territorial _____

Numri i punonjësve (F/M) _____

1. A ka zhvilluar bashkia juaj standartizim të procedurës administrative të njoftimit dhe konsultimit publik? (rregullore e brendshme, urdhra të brendshëm, forma standarte, verifikim)

Po

Jo

2. A ka zhvilluar bashkia juaj ndonjë mekanizëm apo proces të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët? (si psh: dëgjesa publike për PPV, dëgjesa për dhëgjesa për dhënie të pronave, plane veprimi, dëgjesa për Buxhetimin me Pjesëmarrje, etj)? Nëse po, cilët janë ato për periudhën shtator 2023 – Maj 2024?

3. Ndër ta, cilin do veçonit si një ndër mekanizmat që ka rezultuar më efektiv?

4. Prej sa kohësh janë realizuar dëgjesa dhe konsultime publike në bashkinë tuaj?

Më pak se 6 muaj

6 muaj – 1 vit

²⁷ Tirane, Durrës, Vlorë, Puke, Elbasan, Fier, Kukes, Shkoder, Vau i Dejes, Korce

1 – 3 vit

Mbi 3 vjet (specifiko sa) _____

5. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

- Këshilli Bashkiak
- Kryetari i Bashkisë
- Stafi i Bashkisë
- Organizata jofitimprurëse lokale
- Projekt i realizuar me donatorë
- Tjetër (specifiko) _____

6. A ka vendime, urdhëra të brendshëm të miratuara nga Kryetari i Bashkisë apo Këshilli Bashkiak për programin e transparencës (verifikoni në disa raste është kërkuar të rishikohen programet e transparencës për 2023 - 2024?)

Po Jo

7. Nëse po, ju lutem siguron një kopje elektronike të dokumentacionit për efekt studimi, verifiko nëse plotësohen kërkesat e fushës 6 – Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje?

8. Nëse ka pak informacion dhe ato janë pjesërisht të publikuara në faqen e internetit, pse?

- Mendoni që nuk është e nevojshme
- Nuk ka kapacitete brenda bashkisë për të hartuar një dokumentacion të tillë
- Nuk keni gjetur një praktikë për t'u përshtatur në bashkinë tuaj
- Tjetër

9. Si është i organizuar procesi i njoftimit dhe konsultimit publik (hapat e procesit, përfshirë ideimin e projekt-akteve, njoftimin për konsultimin publik në rregjistrin elektronik, numrin e takimeve dhe specifika për çdo takim, ku organizohen, kush merr pjesë, menaxhimi i informacionit dhe rekomandimeve nga qytetarët dhe ku reflektohen).

10. A ka bashkia juaj Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Kush është përgjegjës për këtë strukturë? (saktësoni drejtorinë nga varet ky pozicion)?

11. Cilat drejtori apo sektore të tjerë të Bashkisë përfshihen në proceset e njoftimit dhe konsultimit publik?

12. Si e siguron pjesëmarrjen e gjithë grupeve të synuara në proceset me pjesëmarrje?

13. Cilat janë mjetet që përdorni për njoftimin dhe përfshirjen e qytetarëve në këtë proces? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Regjistri elektronik	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale					
Botim në gazetatat lokale	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

14. Si merren komentet dhe rekomandimet në procesin e konsultimit publik në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A shpjegohen arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë?
 Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre?
 Po Jo

A afishohet/publikohet adresa e kontaktit të koordinitorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?
 Po Jo

A publikohet dhe kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

15. A keni regjistër ose plan vjetor për procesin e vendimmarjes me pjesmarrje (dëgjesat publike)?

Po Jo

16. Si funksionon ky regjistër/plan? A përditësohet sistematikisht? (Verifiko faqen zyrtare e internetit ku publikohen projekt-aktet, që ngarkon me përgjegjësi organet që duhet të publikojnë të gjithë procedurën e konsultimit publik të projekt-aktit)

17. Kush është përgjegjës për përditësimin e tij?

18. Është i publikuar ky regjistër/ plan vjetor(online)?

Po Jo

19. A mbahet dhe publikohet procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun?

Publikimi online	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Procesverbali i takimeve	1	2	3	4	5

20. Keni statistika mbi përfshirjen e qytetarëve? Nëse po, specifikoni edhe me shifra (kjo pyetje për koordinatorin e Konsultimit Publik, drejtoritë e tjera nuk kanë statistika, thjesht merrni ndonjë ide sa informacione kanë)?

- Total _____
- Të ndarë sipas gjinisë _____
- Të ndarë sipas njësive administrative _____
- Organizata jofitimprurëse lokale _____
- Subjekte private _____
- Të rinj _____
- Persona të papunë _____
- Persona me nevoja të veçanta _____
- Të pastrehë _____
- Tjetër _____

21. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik?

- Po Jo

22. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi të (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin).

23. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik në bashkinë tuaj?

24. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

25. Nëse po/jo shpjegoni si:

26. Cilat do të ishin nevojat për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

- Procedura
- Burime njerëzore

- Burime financiare
- Burime materiale
- Infrastrukturë e përshtatshme
- Asistencë teknike/Trajnime
- Tjetër

27. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Aneks 5: Pyetësi me anëtarë të Këshillit Bashkiak

VLERËSIMI I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR PER KESHILLIN BASHKIAK

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike" financuar nga National Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara²⁸, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për këshillin bashkiak:

Bashkia

Nr. i këshilltareve

Nr. i ndarë sipas gjinisë

Nr. i komisioneve

3. Në opinionin tuaj si këshilltar vendor, sa e rëndësishme është pjesëmarrja e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimarrjes së Këshillit Bashkiak?

Perceptimi	Shumë e rëndësishme	E rëndësishme	Disi e rëndësishme	Pak e rëndësishme	Aspak e rëndësishme
Informimi dhe njoftimi i bashkësisë	1	2	3	4	5

²⁸ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Këshillimi me bashkësinë					
Përfshirja qytetare në vendimmarrje					

4. Nëse Po, ju lutem jepni sqarime për alternativën e zgjedhur.

5. A e njihni bazën ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendim marrjen vendore? (Saktëso nëse ka rregullore të KB dhe nëse e kanë lexuar apo e kanë bërë pjesë të punës së tyre)

6. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor? (mund të zgjidhni më shumë se sa një alternativë)

- Është i qartë dhe i plotë
 Është i qartë, por jo i plotë
 Është i paqartë, por i plotë
 Është i paqartë dhe jo i plotë

7. Nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja në këtë drejtim?

8. Keni rregullore dhe procedura të brendshme të miratuara për realizimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik? Nëse po, ju lutem specifikoni. (Shënim për intervistuesin: Të merret një kopje e dokumentacionit, të specifikohet nr. i vendimit të rregullores së KB)

9. A ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit publik?

Po Jo

10. Nëse po, si realizohet ky bashkëpunim?

11. A ka Këshilli Bashkiak infrastrukturën e duhur për realizimin dhe ndjekjen e proceduarve të ligjit për njoftimin dhe konsultimit publik?

Po Jo

12. Në dijëni tuaj, cilat janë mjetet që përdor Këshilli Bashkiak për njoftimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik:

- Regjistri elektronik
- Posta elektronike (e-mail)
- Lajmërim publik i afishuar në ambjentet e bashkisë
- Lajmërim në mediat audio-vizive lokale
- Lajmërim në mediat sociale (Facebook, etj)
- Botim në gazetatat lokale
- Tjetër (ju lutem specifikoni) _____

13. A ka Këshilli një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për Njoftimin dhe Konsultimin Publik?

Po Jo

14. Nëse po, ju lutem shpjegoni si funksionon ky mekanizëm, cila është linja e raportimit, kush e monitoron?

15. A raportohet në Këshillin Bashkiak mbi proceset që rrjedhin nga ligji Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe rekomandimet që dalin prej tij?

Po Jo

16. Nëse po, si i miratoni projekt aktet/vendimet e proceve të konsultimit dhe rekomandimet që dalin prej tij?

- Të përfshira në projekt buxhetin e propozuar nga Bashkia
- Pikë e veçantë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak
- Tjetër (ju lutem specifikoni)

17. A ka patur raste të kthimit të projekt vendimeve nga Këshilli Bashkiak për shkak të mosrealizimit të njoftimit dhe konsultimit publik? Nëse po, specifikoni.

18. Në rastin e miratimit të projekt vendimeve që janë marrë bazuar në njoftimin dhe konsultimin publik, a ndiqet nga ana e Këshillit Bashkiak zbatimi i tyre:

Po Jo

19. Cilat janë disa nga mekanizmat e pjesëmarrjes dhe konsultimit që Këshilli juaj përdor me qytetarët:

Format e njoftimit dhe konsultimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Buxhetimi me pjesëmarrje	1	2	3	4	5

Seanca dëgjimore të Këshillit Bashkiak	1	2	3	4	5
Faqja e internetit e bashkisë	1	2	3	4	5
Diskutime në media lokale	1	2	3	4	5
Seanca dëgjimore publike organizuar nga këshilltarët	1	2	3	4	5
Takimet në lagje, fshatra, njësi administrative					
Komisionet këshillimore qytetare	1	2	3	4	5
Konsultime me ekspertë	1	2	3	4	5
Studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve, pyetësorë online	1	2	3	4	5
Mediat sociale, platformat online ose telefonatat	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

20. Për cilat akte/dokumenta të përmendura mëposhtë keni kryer konsultime me publikun (periudha shtator 2023- maj 2024/2024)?

- Planet strategjike (specifiko)
- Buxheti afatmesëm i bashkisë
- Buxheti vjetor i bashkisë
- Tarifat dhe taksat
- Projektet e investimeve
- Adminstrimin e aseteve dhe pronave
- Rregullore dhe plane veprimi
- Tjetër (Ju lutem specifikoni) _____

21. A e masni kënaqësinë e qytetarëve lidhur me mekanizmat e marrjes së mendimeve të qytetarëve që përdor Këshilli juaj?

Matshmëria	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Kënaqësia e qytetarëve	1	2	3	4	5

22. A keni patur ankesa nga qytetarët/grupe interesi lidhur me pjesmarrjen qytetare konsultimin publik?

Po Jo

23. Nëse po, si procedohet me ankesën?

24. Si njoftohen qytetarët lidhur me këtë çështje?

25. Sa ka qenë numri i ankesave në dy vitet e fundit? _____

26. A keni sistem monitorimi dhe vlerësimi të mekanizmave të përdorur?

Po Jo

27. Nëse po, jepni më shumë informacion mbi to (indiktorët që maten, kush është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin)?

28. A miratoni raporte vjetore të hartuara nga Këshilli Bashkiak për transparencën e proceseve vendim marrëse?

Po Jo

29. Si i vlerësoni kapacitetet e këshillit bashkiak për proceset e konsultimit ?

Perceptim	Shumë të aftë	Të aftë	Disi të aftë	Pak të aftë	Jo të aftë
Kapacitetet e këshillit bashkiak	1	2	3	4	5

30. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që ndeshni në angazhimin dhe konsultimin me publikun?

31. Çfarë nevojash do të kishit për të përmirësuar më tej këto procese?

32. Si vlerësoni situatën mbi zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

Aneks 6: Pyetësi me grupet e interesit

VLERËSIMI I PRAKTIKAVE TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË NIVEL VENDOR

Kjo intervistë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike” financuar nga National

Endowment for Democracy. Pyetësi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara²⁹, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore.

Gjetjet nga intervistat do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të procesit të njoftimit dhe konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe faktorët e suksesit në zbatimin e tyre. Informacioni i dhënë dhe opinionet do të përdoren për përshkrimin e rasteve studimore, në kuadër të këtij studimi. Rrjeti POP, garanton pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra gjatë intervistave në 10 bashkitë pilot, të identifikuara për zbatimin e mekanizmave të angazhimit qytetar dhe konsultimit në nivel vendor në Shqipëri.

Informacion i përgjithshëm për grupin e interesit:

Emri _____

Organizatë _____

Biznes _____

Aktivist _____

33. Keni informacion se ju keni të drejta si person ose përfaqësues i palëve të interesuara për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik që organizon bashkia/këshilli bashkiak për vendim marrje të ndryshme që prekin jetën e komunitetit?

Po

Jo

34. Cilat janë mjetet që jeni njoftuar për njoftimin dhe konsultimin publik? Ju lutem specifikoni shpeshësinë e përdorimit në rastin kur aplikohet.

Format e njoftimit	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Njoftime nga rregjistri elektronik/façe web bashkia	1	2	3	4	5
Posta elektronike (e-mail)	1	2	3	4	5
Lajmërim publik afishuar në ambjentet e bashkisë	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat audio-vizive lokale	1	2	3	4	5
Lajmërim në mediat sociale (Facebook, IG etj)	1	2	3	4	5
Lajmërim individuale	1	2	3	4	5
Botim në gazetate lokale	1	2	3	4	5
Tjetër, administrotori, kryeplaku, ndërlidhësi komunitar.	1	2	3	4	5

35. Nëse po ju lutem specifikoni ku nga konsultimet e mëposhtme keni marrë pjesë ose keni kontribuar?

Format e pjesëmarrjes	Gjithmonë	Shpesh	Ndonjëherë	Shumë rrallë	Asnjëherë
Dëgjesa për projekt buxhetin vendor 2023- 2024	1	2	3	4	5

²⁹ Tirane, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

Dëgjesa për taksat dhe tarifrat vendore	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshime në Planin e Përgjithshëm Vendor	1	2	3	4	5
Dëgjesa për ndryshimin/tjetërsimin ose dhënien në përodrim të pronave të të tretëve.	1	2	3	4	5
Dëgjesa për miratimin e normave, standarteve e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve, si dhe për mbrojtjen e garantimin e inetrësitet publik (Dëgjesa për plane veprimi vendore dhe rregullore të ndryshme)	1	2	3	4	5
Tjetër	1	2	3	4	5

36. Nëse keni marrë pjesë, a keni dhënë rekomandime/propozime për Bashkinë ose Këshillin Bashkiak me shkrim ose elektronikisht te koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik?

- Gjithmonë
 Ndonjëherë
 Asnjëherë

37. A keni raste bashkëpunimime bashkinë ose këshillin bashkiak për të marrë pjesë, këshilluar ose për të organizuar takime publike në favor të grupit që ju përfaqësoni?

Po Jo

38. Nëse po, rekomandimet tuaja janë marrë parasysh? Po Jo

39. Kush i ka iniciuar procesin e njoftimit dhe konsultimit publik? (sqaro për cdo rast)

-
- Këshilli Bashkiak
 Stafi i Bashkisë
 Organizata jofitimprurëse lokale
 Projekt i realizuar me donatorë
 Tjetër (specifiko) _____

40. Në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik që ju keni marrë pjesë në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike:

- A u janë shpjeguar arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projekt-aktit, si dhe ndikimi që ai ka?
 Po Jo

Afati, vendi dhe mënyra me të cilën, ju si palë të interesuara do të paraqesni ose dërgojnë rekomandimet tuaja? Po Jo

A u është treguar ose publikuar adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin?

- Po Jo

Sa kohe në dispozicion keni për të marrë pjesë në një konsultim publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij?

41. Mendoni se rekomandimet tuaja janë marrë parasysh? A besoni se konsultimet publike sjellin ndryshime reale, apo bëhen vetëm për procedurë?

42. Në konsultimet publike të organizuara a ju kanë vënë në dispozicion materiale të projek-aktit për ta shqyrtuar dhe për të dhënë rekomandime? (Nëse po, ju lutem siguroni një kopje të dokumentacionit për efekt studimi)

43. Nëse nuk keni qënë dakord me projekt-aktin dhe keni dhënë rekomandime, komente e vërejtje, a keni patur kohë në dispozicion për ti referuar dhe cila është rruga që keni ndjekur më poshtë?

- keni përgatitur kërkesë-ankesë dhe rekomandime për ndryshim
- keni mbledhur firma të qytetarëve dhe grupeve të interesit për ta kundërshtuar
- jeni ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin e punës së bashkisë dhe vendim marrjen e këshillit bashkiak.
- keni komunikuar me mediat dhe grupet e interesit
- Tjetër

44. Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?

45. Në këndvështrimin tuaj, a është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të proceseve të infomimit dhe konsultimit për ta?

46. Nëse po/jo shpjegoni si:

47. Cilat do të ishin rekomandimet tuaja për ta përmirësuar më tej zbatimin e këtij procesi në të ardhmen?

FALEMINDERIT PËR BASHKËPUNIMIN!

POP

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Aneks 7: Pyetësi i shpërndarë online për qytetarët

OLOF PALME INTERNATIONAL CENTER **Suedi Sverige** **NED NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY**

PYETËSOR ONLINE

Tiranë Durrës
Fier Elbasan
Shkodër Vau i Dejës
Pukë Kukës
Vlorë Korçë

www.popnetwork.al

POP
PERBALLJA OFERTAVE POLITIKE

Perceptimi i qytetarëve mbi njohimin dhe konsultimin publik!

Faleminderit për pjesëmarrjen në këtë anketim! Kontributi juaj është i vlefshëm për të kuptuar perceptimet publike mbi njohimin dhe konsultimin publik në nivel vendor. Kjo anketë zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikën e njohimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Vlerësimi zhvillohet nga rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” në kuadër të projektit “Niveli e Mëkëqytetues Qytetare mbi Përgjegjëshmërinë Publike” financuar nga National Endowment for Democracy. Ai ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Kukës, Pukë, Vau i Dejës) për të pasqyruar perceptimin e qytetarëve mbi njohimin dhe konsultimin publik në këto njësi të qeverisjes vendore dhe impaktin në vendimarrje përmes konsultimit.

Ju lutemi, përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme me sinqeritet dhe duke u bazuar në atë njohuri sa keni. Nëse keni pyetje, ju lutem kontaktoni: perballjaofertavepolitike@gmail.com

Konsultimi Publik

* 1. Bashkia:

This is a question help text.

Lutemi zgjidhni vetëm njëra nga mundësitë e mëposhtme

2. Gjinia:

Lutemi zgjidhni vetëm njëra nga mundësitë e mëposhtme

Fëmër
 Mashkull
 Pa përgjigje

POP - Perballja e Ofertave Politike

RRJETI POP

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike – POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."

KONTAKT

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1,
Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>